



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

MONITORI I RREGULLOREVE DHE VENDIMEVE
TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR MUAJT JANAR-QERSHOR TË VITIT 2012

Qershor, 2012

Komuna e Gjakovës

Janar – Qershor 2012

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në muajin janar-qershor të vitit 2012 ka miratuar 16 vendime.

Vendimet

1. Vendim mbi ndryshimin e vendimit me nr.011-3801, i datës 27.05.2010 i Kuvendit të Komunës së Gjakovës për formimin e Komisionit për identifikimin e banesave, dhënien në shfrytëzim të banesave në ndërtesën për banim social.

Me këtë vendim anëtari i komisionit z. Ilir Beqiri zëvendësohet me znj. Flloza Rexhepi.

2. Vendim mbi miratimin e kërkesës për shfuqizimin e Rregullores për EKO-taksa me nr. të vendimit 01 Nr.06-011-4580/2011 i datës 26.07.2011.

Me këtë vendim shfuqizohet Rregullorja për EKO-taksa, mbi bazën e rekomandimit të Komisionit ndërministror MMPH-MAPL për vlerësim të ligjshmërisë së akteve komunale nga fusha e mjedisit.

3. Vendim mbi miratimin e kërkesës për plotësim-ndryshimin e Statutit të Komunës së Gjakovës.

Me këtë vendim nenit 55 të Statutit të Komunës i shtohet përgjegjësia: i. i. Mbrojtja e tokës në pronësi komunale nga uzurpimet dhe udhëheqja e procedurave të ndërlidhura me këtë çështje. Ndërsa, nenit 56 i hiqet nga teksti pjesa e përgjegjësive e përshkruar me shkronjën t.- mbrojtja e pronës komunale nga uzurpimet dhe udhëheqja e procedurave lidhur me këtë çështje.

4. Vendim për formimin e komisionit në Komunën e Gjakovës për organizimin e manifestimeve për nder të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit me përbërje prej 7 anëtarëve.

5. Vendim për miratimin e kërkesës për plotësimin e vendimeve mbi caktimin tokës ndërtimore urbane G.Z.ksak nr.27/79, G.Z. ksak nr.37/88, G.Z.R.S nr.11/93, G.Z.R.S nr.11/94 dhe vendimi mbi caktimin e tokës ndërtimore urbane në zonën industriale të qytetit nr.01-zyrtar 17.04.2002, e propozuar nga Drejtoria e Urbanizmi dhe Mbrojtje të Mjedisit.

6. Vendim për aprovimin e raportit financiar të Buxhetit të Komunës së Gjakovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2011.

7. Vendim për aprovimin e kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për lëvizjet Buxhetore nga kategoria e Investimeve Kapitale në vlerë prej 38.630.00€, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në mallra e shërbime për mbulimin e shpenzimeve emergjente (pastrimin e borës).

Me këtë vendim autorizohet Drejtoria për Financa dhe Ekonomi që të kryej të gjitha procedurat e nevojshme, për transferin e mjeteve financiare sipas të dhënave të përshkruara në pikën e parë të këtij vendimi.

8. Vendim për miratimin e kërkesës së z. Rexhep Jemin Kastrati nga Gjakova për dhënien në shfrytëzim të një pjese prej 0,02.22 (222 m²) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 0.16.37.ha të palujtshmërisë në ngastrën 5526/34 zk Gjakovë - J për destinim shndrimi në "Oaz të Gjelbëruar".

9. Vendim mbi miratimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës dhe Bordit të Drejtorëve për shpalljen e ish'kryetarit të Jugosllavisë inekzistente z. Stipe Mesiq, "Qytetar Nderi I Komunës së Gjakovës".

Ky vendim është miratuar me arsyetimin se z. Mesiq ishte mbështetës I fuqishëm për të drejtat e shqiptarëve nën regjimin Jugosllav.

10. Vendim për miratimin e kërkesës së Komunës së Shëngjinit Republika e Shqipërisë për Binjakëzim me Komunën e Gjakovë.

11. Vendim për miratimin e Projektit ideor Urbanistiko-Arkitëktonik I Kampusit Universitar.

Ky vendim është propozuar për shqyrtim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

12. Vendim për miratimin e Planit Rregullues Urban I Kompleksit Urbanistik, potezit përgjatë rrugës regjionale Gjakovë-Prizren, ana jugore (Ish-poligoni I autoshkollës).

Ky vendim është propozuar për shqyrtim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

13. Vendim për aprovimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës për ngritjen e Shtegut Memorial i cili duhet të realizohet në kuadër të Planit Urbanistik Arkitektonik "Parku i Qytetit" në Gjakovë.

Më këtë vendim formohet grupi punues I cili i cili do të angazhohet për definimin e të dhënave për vendosjen e shtatorëve, pllakave me emrat e dëshmorëve dhe martirëve të përfshirë në këtë shteg memorial, me përbërje prej përfaqësuesve të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës dhe përfaqësuesve të tri shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së.

14. Vendim për miratimin e rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për shfuqizimin e vendimit 01nr. 011-1644/2012 i datës 29.03.2012.

15. Vendim për miratimin e Propozimit të Kryetarit të Komunës për ngritjen e shtatores së dëshmorit Agron Rama në sheshin "Epopeja e Koshares" .

16. Vendim për formimin e grupit punues i cili do të angazhohet për definimin e kriterëve për ndërtimin e shtegut memorial në përbërje prej 14 anëtarëve.

Komuna e Junikut

Janar - Qershor 2012

Kuvendi i Komunës së Junikut në muajin janar-qershor të vitit 2012 ka miratuar 3 rregullore dhe 8 vendime.

Rregulloret

1.Rregullore për përdorimin e pijeve alkoolike në lokalet publike brenda territorit të Komunës së Junikut.

2. Rregullore për punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut

Me këtë rregullore përcaktohet përbërja, kompetencat, aktivitetet, mënyra e punës dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare në komitetet e Kuvendit të Komunës konform dispozitave të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Statutit të Komunës.

3. Rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Junikut

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për përdorimin e rregullt, efikas, racional dhe ekonomik të automjeteve të Komunës së Junikut

Vendimet

1.Vendim për caktimin e orarit të takimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2012.

2. Vendim për caktimin e orarit të takimeve të Kuvendit Komunal në Junik për vitin 2012.

3. Vendim mbi rritjen e mjeteve vetanake të vitit 2011.

Me këtë vendim, shuma totale e të hyrave vetanake për vitin 2011 duke përfshirë edhe gjokat në trafik në vlerë prej 1,510.00 €, gjokat Gjykatave 0.00 € dhe Agjensionit Pyjor

në vlerë prej 8,164.54 € planifikohet të jetë gjithsej: 75,568.16 € . Shuma e planifikuar ka qenë 50,650.00 €, kurse rritja është në vlerë prej 24,918.16 €.

Nga kjo rritje shuma 24,918.16€ do të bartet në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedisi në kategorinë e shpenzimeve kapitale me vlerë prej 22,798.16€, ndërsa shuma e mjeteve prej 2,120.00€ do të bartet në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, në nënprogramin 74200 (Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor).

4. Vendim mbi bartjen e mjeteve të pa shpenzuara vetanake të vitit 2011.

Me këtë vendim do të bëhet bartja e mjeteve të pa shpenzuara vetanake të vitit 2011, sipas kategorive ekonomike. Nga shuma 75,568.16 €, gjate vitit 2011 janë shpenzuar 27,054.82 € për investime kapitale dhe subvencione, kurse pjesa tjetër në vlerë prej 48,513.34 € ka mbetur e pashpenzuar kështu që do të bartet në vitin 2012. Kësaj shume i bashkëngjiten edhe të hyrat e bartura të pa shpenzuara të cilat janë në vlerën prej 1,285.60 €, që gjithsejtë për bartje janë 49,798.94 €.

5. Vendim për shpalljen e ngastrave kadastrale 1959 dhe 3298/1 interes publik i Komunës së Junikut

Me këtë vendim Me këtë vendim shpallet interes publik i Komunës së Junikut për ngastrat kadastrale numër: 1959 dhe 3298/1. Ngastra Kadastrale Nr.1959 evidentohet ne Te Dhënat Bazë për Njësi P-73105038-01959-0 është pasuri shoqërore e ndërmarrje Moronica, ka sipërfaqe te përgjithshme 9275 m² me kulturë është kullosë dhe gjendet ne vendin e quajtur Moronica.

6. Vendim për themelimin e çmimit “Kuvendi I Junikut”.

Me këtë vendim themelohet çmimi “Kuvendi I Junikut”, I cili mund t’iu ndahet personaliteteve dhe institucioneve të veçanta të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në zhvillimin e proceseve historike kombëtare, vlerave demokratike dhe universale.

7. Vendim për ndarjen e çmimit “Kuvendi I Junikut”.

Ky vendim është miratuar për ndarjen e çmimeve me rastin e 100 vjetorit të Kuvendit të Junikut, si çmim I parë për: Hasan Prishtinën (Post mortum), Familjen Jasharaj (post mortum), Familjen Haradinaj, Familjen Rugova, Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Hashim Thaqi, Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë Dr. Sali Berisha, Institucionit - “Oda” të Junikut.

8. Vendim mbi miratimin e Rishikimit të Buxhetit Komunal në Komunën e Junikut për vitin 2012

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Junikut ka miratuar rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2012 me ndryshimet e bëra nga granti Qeveritar dhe atë në kategorinë paga dhe medijtje dhe shpenzime kapitale.

Komuna e Deçanit

Janar – Qershor 2012

Kuvendi i Komunës së Deçanit në muajt janar-qershor të vitit 2012 ka miratuar 1 rregullore dhe 10 vendime.

Rregulloret

1.Rregullore për caktimin e lartësisë së taksave dhe ngarkesave për shërbimet komunale Me këtë rregullore përcaktohet lartësia e taksave dhe ngarkesave për shërbimet e ofruara qytetarëve dhe personave juridik, nga institucionet e Komunës së Deçanit

Vendimet

1. Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për lartësinë e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbimet komunale 01. Nr .X- 6 datë 29.09.2010.

Sipas këtij Vendimi plotësohet dhe ndryshohet neni (4) neni(9), neni (10) dhe neni 14 i Rregullores për Lartësinë e Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave për Shërbimet Komunale.

2. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e mjaltit “Golden Honey-Deçan”

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Fabrikës së Mjaltit “GOLDEN HONEY-DEÇAN”, në parcelën nr.70505021-00342-0, Zona Kadastrale Deçan, Kultura-Mal i klasit 3, e evidentuar si pronë komunale, me sipërfaqe të përgjithshme 01.27.92 ha.

3. Vendim mbi aprovimin e planit të punës së kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2012

Me këtë vendim aprovohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2012.

4. Vendim për përshtatje buxhetore për fondin e shpenzimeve të paparashikuara për tejkalimin e situatës së shkaktuar nga kushtet e vështiruara klimatike

5. Vendim mbi aprovimin e raportit të shpenzimeve për pastrimin e borës

Me këtë vendim aprovohet raporti i shpenzimeve për pastrimin e rrugëve të Komunës së Deçanit pas situatës së shkaktuar nga gjendja e jashtëzakonshme e të reshurave të borës.

6. Vendim mbi aprovimin e raportit të shpenzimeve në sektorin e sportit

Me këtë vendim aprovet raporti i shpenzimeve në Sektorin për Sport në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte të Komunës së Deçanit.

7. Vendim mbi aprovimin e raportit analitik të shpenzimeve për vitin 2011

Me këtë vendim aprovet raporti analitik i shpenzimeve të Komunës së Deçanit për vitin 2011.

8. Vendim mbi aprovimin e rishikimit të buxhetit të komunës së Deçanit për vitin fiskal 2012

Aprovet Rishikimi i Buxhetit të Komunës së Deçanit për vitin fiskal 2012.

9. Vendim për aprovimin e Planit të Veprimit në Mjedis në Komunën e Deçanit.**10. Vendim për emërtimin e rrugëve.**

Komuna e Rahovecit

Janar – Qershor 2012

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në muajt janar-qershor të vitit 2012 ka miratuar 15 vendim dhe 2 rregullore.

Rregulloret

1. Rregullore për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat fillore dhe të mesme te ulëta në Komunën e Rahovecit**1. Rregullore për lehtësirat për investuesit e jashtëm dhe bizneset vendore fillestare**

Më këtë Rregullore krijohet mundësia që komunën e Rahovecit ta bëjmë më tërheqëse për investuesit e huaj dhe për themelimin e bizneseve vendore fillestare.

Vendimet

1. Aktvendim me të cilën ndërpritet shfrytëzimi i mëtutjeshëm i tokës bujqësore në pronësinë shoqërore të NBI-së "Rahoveci" në Rahovec dhe rikthehet në emër të PSH të Kosovës, KK Rahovec, paluajtshmëria e cila gjendet jashtë kompleksit bujqësor.

2. AKTVENDIM për aprovimin e kërkesës së Kompanisë private KNGS Sh.p.k. Prishtinë, dhe i ndahet në shfrytëzim me konsesion prona e paluajtshme komunale, për ndërtimin dhe operimin e objektit për tregtimin e lëndëve djegëse - gazit të naftës së lëngëzuar, në kohëzgjatje prej 10 (dhjet) vjet me të drejtë vazhdimi, ngastra kadastrale nr. 42/2, sipas kulturës kullosë e kl. 6, në sipërfaqe prej 0.50,00 ha, nga çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 274 z.k. Hoçë e Madhe, PSH e Kosovës, KK Rahovec.

3. Vendim për vazhdimin e kontratës koncesionare për dhënie në shfrytëzim të hotel "Park" në Rahovec

Me këtë vendim vazhdohet kontrata aktuale 01 Nr. 80 e datës 13.07.2011 e lidhur në mes të Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe " , për shfrytëzimin e objektit Hotel "Park" në Rahovec.

4. Vendim për miratimin e Kodit Etik të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Rahovecit.

5. Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Rahovec

Me këtë vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit Komunal të Rahovecit, dhe për anëtarë të tij, emërohen: Xhemali Haxhimustafa, PDK, kryesues; Labinot Berisha, AAK, anëtar; Lumturije Hoti, PDK, anëtare; Sinan Ejupi, AKR, anëtar; Kujtim Popaj, LDK, anëtar; Rasim Fazliu, PDK, anëtar; Nahit Elshani, LDK, anëtar; Feim Fetoshi, AAK, anëtar; Rukije Krasniqi, LIB, anëtare.

6. Vendim mbi zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës

7. Vendim për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Rahovecit .

8. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi përcaktimin e kushteve higjieniko-teknike të objekteve afariste për qarkullim të mallrave dhe shërbimeve

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja mbi përcaktimin e kushteve higjienike-teknike të objekteve afariste për qarkullim të mallrave dhe shërbimeve të KK së Rahovecit 01 Nr. 274 të dt. 02.10.2003, si vijon:

- Në emërtimin e Rregullores shlyhen fjalët "Licencimi i lokaleve afariste".

- Në të gjitha nenet tjera të kësaj Rregulloreje ku përmenden fjalët "leja e punës", zëvendësohet me fjalën "pëlqim".

9. Aktvendim për bartjen e të drejtës së pronës së paluajtshme nga PSH e Kosovës, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në emër të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, shfrytëzuese Qendra Mjekësisë Familjare Krushë e Madhe, ngastra kadastrale nr. 913, ndërtesë në sipërfaqe prej 267 m2, oborr në sipërfaqe prej 500 m2 dhe kullosë në sipërfaqe prej 393 m2, nga çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 1. z.k. Krushë e Madhe.

10. Aktvendim për aprovimin e kërkesës së Beqir Sadik Hamza, nga Rahoveci, dhe iu jipet në shfrytëzim pa kompensim, si rast social për ndërtimin e shtëpisë banesore, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh me të drejtë vazhdimi, ngastra ndërtimore në pronësinë shtetërore nr. 301-3, sipas kulturës arë e kl. 4 në sipërfaqe prej 0.03,50 ha, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 7 z.k. Bërnjakë, PSH e Kosovës, KK Rahovec. Pas ndërtimit të objektit banesor në pronësinë shtetërore, i përmendurit ka të drejtë të shfrytëzojë tokën nën ndërtesë dhe tokën e cila është e nevojshme për përdorim të vazhdueshëm në kuadër të ngastrës 303-3.

11. Vendim për shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik

Me këtë vendim shpallet zona e veçantë e sigurimit të interesit publik komunal dhe caktohet lokacioni për ngritjen e objekteve afariste për nevojat e ndërmarrjeve publike, dhe atë KRM “Ekoregjioni” - Njësia në Rahovec, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave dhe KRU “Radoniqi” - Njësia në Rahovec, distribuimi i ujit dhe përpunimi i ujërave të zeza, në ngastrën kadastrale nr. 301/2, sipas kulturës arë në vend të quajtur “Pallaticë”, në sipërfaqe prej 1.00,70 ha, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 7. z.k. Bërnjakë, PSH e Kosovës, KK Rahovec.

12. AKTVENDIM për aprovimin e kërkesës së Bashkësisë Islame të Kosovës - Këshilli i Bashkësisë Islame Rahovec dhe i ndahet në shfrytëzim pa të drejtë tjetërsimi për ndërtimin e faltores (xhamisë) me objekte tjera përcjellëse për zhvillimin e riteve fetare, ceremonive dhe ahengjeve të ndryshme për nevojat e banorëve të fshatit Vrajakë, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh me të drejtë vazhdimi, ngastra kadastrale nr. 83/2, sipas kulturës kullosë e kl. 3, në sipërfaqe prej 0.10,00 ha, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 62. z.k. Vrajakë, PSH e Kosovës, titullar KK Rahovec.

13. Vendim mbi kushtëzimin e shfrytëzuesve të shërbimeve komunale

Me këtë vendim obligohen të gjitha bizneset dhe institucionet në tërë Komunën e Komunën e Rahovecit dhe banorët e qytetit të Rahovecit, të cilat shfrytëzojnë shërbimet komunale në grumbullimin dhe transportin e mbeturinave organike, të ofruara nga kompanitë e kontraktuara nga Komuna dhe kushtëzohen të dëshmojnë me kontratë apo vërtetim për shlyerjen e borxheve ndaj kompanive të kontraktuara me rastin e nxjerrjes së dokumentacioneve, si vijon:

1. Vërtetimin mbi taksat komunale për regjistrimin e automjeteve
2. Dokumentacionin kadastral
3. Lejet ndërtimore
4. Vazhdimi i pëlqimit të lejeve të punës për biznes.

14. AKTVENDIM për aprovimin e kërkesës së Adem Hasaj, nga Rahoveci, dhe i ndahet në shfrytëzim pa të drejtë tjetërsimi, toka ndërtimore në pronësinë shoqërore për ndërtimin e shtëpisë banesore në kohëzgjatje prej 10 (dhjet) vjet, me të drejtë vazhdimi, ngastra kadastrale nr. 2240/43, në vend të quajtur “Krajshtë”, sipas

kulturës kullosë e kl. 5, tani truall në sipërfaqe prej 0.03,00 ha, nga fleta e posedimit nr. 611 z.k. Rahovec.

15. Vendim për dhënien e pëlqimit për zgjerimin e kufirit ndërtimor

Me këtë vendim i jepet pëlqimi Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Rahovecit, për zgjerimin e kufirit ndërtimor në qytetin e Rahovecit respektivisht të ngastrës 6057/2, në vendin e quajtur "Bllata", në sipërfaqe prej 0.54.34 ha z.k. Rahovec, të pronarit z.Selami M. Shehu nga Rahoveci, për ndërtimin e objektit afarist - Bodrumi i verës për përpunimin dhe depozitimin e produkteve të rrushit.

Komuna e Hanit të Elezit

Janar - Qershor

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezitinë muajt janar-qershor të vitit 2012 ka miratuar 2 rregullore dhe 27 vendim.

Rregulloret

1.Rregullorja për taksa tarifa dhe ngarkesa.

Me këtë rregullore përcaktohen lartësia e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

2.Rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për përdorimin e rregullt, efikas, ekonomik të automjeteve zyrtare në Komunën e Hanit të Elezit.

Vendimet

1.Vendim për pajisen e anëtarëve të kuvendit me llop-top.

Me këtë vendim anëtarët e kuvendit pajisen me llop-top, personal.

2.Vendim mbi raportit të punës të kryetarit për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratuar raporti i punës së kryetarit për vitin 2012.

3.Vendim mbi raportit të punës të kuvendit të komunës për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratuar raporti punës të kuvendit të komunës për vitin 2012.

4.Vendim mbi përcaktimin e parcelës për ndërtimin e objektit të QPS-së.

Me këtë vendim u miratua propozimi që parcela në fjalë të dedikohet për ndërtimin e objektit të QPS-së.

5.Vendim mbi kërkesa e z. Burhan Kuka për ndërrim të emërimit të vendimit 01.Nr 114/2012.

Me këtë vendim miratuan kërkesën e z.Burhan Kukës për ndërrimin e emërimit të vendimit 01.Nr.114/2012.

6.Vendim mbi rritjen e buxhetit 2011 nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2011.

Me këtë vendim u miratuar rritja e buxhetit 2011 nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2011.

7.Vendim mbi bilancet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2010 dhe të vitit 2011 në vitin vijues 2012.

Me këtë vendim miratohen bilancet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2010 dhe të vitit 2011 në vitin vijues 2012.

8.Vendim mbi raportin të punës së Komitetit për Komunitete.

Me këtë vendim miratohet raporti i punës së Komitetit për Komunitete.

9.Vendim mbi planin e punës së Komitetit për Komunitete.

Me këtë vendim miratohet plani i punës së Komitetit për Komunitete.

10.Vendim mbi raportin e punës së tri Komitetit Konsultative.

Me këtë vendim miratohet raporti i punës së tri Komitetit Konsultative.

11.Vendim mbi planin e punës së tri Komitetit Konsultativ

Me këtë vendim miratohet plani i punës së tri Komitetit Konsultativ.

12.Vendim mbi kërkesën e z. Muhamet Kalisi për dhënien e pëlqimit për vendosjen e gurthyesit në parcelën numër 324-0 dhe 323-0.

Me këtë vendim i jepet pëlqimi kërkesën e z. Muhamet Kalisi për vendosjen e gurthyesit në parcelën numër 324-0 dhe 323-0.

13.Vendim mbi kërkesën e z. Muhamet Kalisi për dhënien e pëlqimit komunalë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në ngastrën kadastrale 1124 fleta poseduese numër 47,, Uji i Bardh,,

Me këtë vendim i jepet pëlqemi kërkesës së z. Muhamet Kalisi për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në ngastrën kadastrale 1124 fleta poseduese numër 47,, Uji i Bardh,,

14.Vendim mbi miratimi e planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratuar plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012.

15.Vendim mbi miratimi planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratuar plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012.

16.Vendim mbi miratimi e kërkesës së z. Burhan Kuka për shfrytëzimin e parcelës 695 për ndërtimin e një miniferme të dhive.

Me këtë vendim kuvendi i komunës e miraton kërkesën e z. Burhan Kuka për shfrytëzimin e parcelës 695 për ndërtimin e një miniferme të dhive.

17.Vendim për heqjen e shpenzimeve të varrimit.

Me këtë vendim miratohet heqja e shpenzimeve të varrimit dhe ju ndihmohet drejtpërdrejt familjeve me raste mortore.

18.Vendim për dhënien e pëlqimit për miratimin e kërkesës së firmës SH.P.K „ Pragu Metal,, për dhënien e pëlqimit për hulumtim të xehes Fe-NI.

Me këtë vendim ju dha pëlqimi firmës SH.P.K „ Pragu Metal,, për hulumtim të xehes Fe-NI.

19.Vendim mbi miratimin e kërkesës së kompanisë „ Sharcem,, për ndërrimin e destinimit të tokës.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e kompanisë „ Sharcem,, për ndërrimin e destinimit të tokës.

20.Vendimi mbi rishikimin e Buxhetit.

Me këtë vendim u bë rishikimi i buxhetit në Komunën e Hanit të Elezit.

21.Vendim mbi projekt Statutin e Bibliotekës së Komunës së Hanit të Elezit.

Me këtë vendim u miratuar Statutit të Bibliotekës së komunës së Hanit të Elezit.

22.Vendim mbi planin lokal të veprimit në mjedis.

Me këtë vendim u miratuar planin lokal të veprimit në mjedis.

23.Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2012.

Me këtë vendim bëhet ndarja mjeteve financiare për javën kulturore 2012 në Komunën e Hanit të Elezit.

24.Vendimi mbi kërkesës së z. Irhan Shkreta për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës pyjore.

Me këtë vendim u miratuar kërkesa e z. Irhan Shkreta për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës pyjore.

25.Vendim mbi Kërkesën e Sharr-cem sh.p.k për hulumtimin e gurit gëlqeror.

Me këtë vendim ju lejohet Sharr-cem për hulumtimin e gurit gëlqeror.

26.Vendim për nismën e bashkëpunimit ndërkufitar.

Me këtë vendim komuna e Hanit të Elezit nis bashkëpunimin me komunën e Haraqinës .

27.Vendim mbi plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme.

Me këtë vendim bëhet plotësim ndryshimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.

Komuna e Vitisë

Kuvendi i Komunës së Vitisë gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 1 rregullore dhe 16 vendime.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare në komunën e Vitisë.

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë të drejtën e përdorimit të rregullt dhe efikas atutmoijetet e komunës së Vitisë.

Vendimet

1.Vendim mbi ndryshimin dhe harmonizimin e statutit të komunës së VitisëMe këtë vendim aprohet ndryshimi dhe harmonizimi I dispozitave të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011. dhe atë : neni 13.1 dhe 13.2, neni 14.3, neni 14.4 , neni 16.5, neni 22.6 dhe neni 46.1.

2.Vendim mbi organizimin kompetencat dhe përgjegjësit e organeve të komunës.

Me këtë vendim përcaktohet organizimi, kompetencat, përgjegjësit dhe struktura funksionale e organeve të administratës në komunën e Vitisë.

3.Vendim mbi raportin e punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2011.

Me këtë vendim miratohet raporti i punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2011.

4.Vendim mbi për rritjen e buxhetit të komunës së Vitisë nga të hyrat vetanake për vitin 2011.

Me këtë vendim bëhet rritja e buxhetit të komunës së Vitisë nga të hyrat vetanake për vitin 2011.

5.Vendimi mbi bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2010 edhe 2011 në vitin 2012.

Me këtë vendim bëhet bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2010 edhe 2011 në vitin 2012.

6.Vendimi mbi qasjen në hartimin e planit Rregullues Urban për zonën veriore të qytetit të Vitisë.

Me këtë vendim fillohet me hartimin e planit Rregullues Urban për zonën veriore të qytetit të Vitisë.

7.Vendimi mbi ndarjen e një lokacioni për ndërtimin e ambulancës në fshatin Pozhoran.

Me këtë vendim bëhet ndarja e një lokacioni për ndërtimin e ambulancës në fshatin Pozhoran.

8.Vendim mbi Pasqyrat financiare të buxhetit të komunës së Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2011.

Me këtë vendim u miratuan Pasqyrat financiare të buxhetit të komunës së Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2011.

9.Vendim mbi shqyrtimin e bilancit të gjendjes për vitin 2011.

Me këtë vendim u miratua bilanci i gjendjes për vitin 2011 në komunën e Vitisë.

10.Vendimi për anulimin e pozicionit nga buxheti i komunës së Vitisë për vitin 2012 „Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatin Ramjan,„

Me këtë vendim anulohet vendimi i mëparshëm për anulimin e pozicionit nga buxheti i komunës së Vitisë për vitin 2012 „Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatin Ramjan,„.

11.Vendimi për miratimin e projektit për rregullimin e kanalizimit në fshatin Ramjan.

Me këtë vendim miratohet projekti për rregullimin e kanalizimit në fshatin Ramjan.

12.Vendimi për shfuqizimin e autorizimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë që të ketë të drejtën e këmbimit të pronës komunale me atë shoqërore të menaxhuar nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit

Me këtë vendim u shfuqizua autorizimi i Kryetarit Komunës së Vitisë që të ketë të drejtën e këmbimit të pronës komunale me atë shoqërore të menaxhuar nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit.

13.Vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për fillimin e negociatave për këmbimin e pronës komunale me pronë shoqërore e cila menaxhohet dhe administrohet nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit.

Me këtë vendim u autorizuar Kryetari i Komunës së Vitisë për fillimin e negociatave për këmbimin e pronës komunale me pronë shoqërore e cila menaxhohet dhe administrohet nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit.

14.Vendim mbi pasqyrat financiare të buxhetit të komunës së Vitisë për periudhën Janar-Mars 2012.

Me këtë vendim u miratuan pasqyrat financiare të buxhetit në komunën e Vitisë për periudhën Janar-Mars 2012.

15.Vendim mbi ndryshimin e Rregullores për mbrojtjen e mjedisit të komunës së Vitisë.

Me këtë vendim u miratua ndryshimi i Rregullores për mbrojtjen e mjedisit të komunës së Vitisë.

16.Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e monumentit përkujtimor për : Sahit Gorani, Zukë Zuka dhe Balë Ahmeti në ngastrën e kadastrave 1090-0YK Gërmovë.

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e monumentit përkujtimor për : Sahit Gorani, Zukë Zuka dhe Balë Ahmeti në ngastrën e kadastrave 1090-0YK Gërmovë.

Komuna e Obiliqit

Kuvendi i Komunës së Obiliqit gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 2 rregullore dhe 21 vendime.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullorja për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme.

Më këtë rregullore, rregullohet shfrytëzimi i përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme.

2.Rregullorja për shërbimin e transportit me merimangë në territorin e komunës së Obiliqit.

Kjo Rregullore u miratua dhe Ka të bëjë me shërbimet e transportit me merimangë në territorin komunës së Obiliqit.

Vendimet

1.Vendim mbi rritjen e buxhetit sipas formës tabelore.

Me këtë vendim buxheti I planifikuar është 494,638.00, buxheti i tejkaluar 129,270.63, ndërsa buxheti i tejkaluar nga të hyrat vetanake 623,908.63.

2.Vendim mbi kërkesën e Organizatës së Luftës së UÇK-së, dega në Obiliq, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2.500 euro, për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Me këtë vendim u miratuar kërkesa e Organizatës së Luftës së UÇK-së, dega në Obiliq, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2.500 euro, për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

3.Vendim mbi kërkesën e Muharrem Shalakut nga fshati Dardhishtë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2.000 euro, për mjekim pasi që vuan nga sëmundja karcinome.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Muharrem Shalakut nga fshati Dardhishtë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 2.000 euro, për mjekim pasi që vuan nga sëmundja karcinome.

4.Vendim mbi kërkesën e Shoqatës së personave me aftësi të kufizuar Handikos-it, Zyra lokale në Obiliq për ndarjen e mjeteve financiare në 3.660 euro, për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Shoqatës së personave me aftësi të kufizuar Handikos-it, Zyra lokale në Obiliq për ndarjen e mjeteve financiare në 3.660 euro, për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre.

5.Vendim mbi refuzimin e kërkesës së Halim Morinës, nga Obiliqi për dhënien në shfrytëzim të parcelës pranë kishës ortodokse për ndërtimin e objektit montues të përkohshëm për autolarje.

Me këtë vendim refuzohet kërkesa e Halim Morinës, nga Obiliqi për dhënien në shfrytëzim të parcelës pranë kishës ortodokse për ndërtimin e objektit montues të përkohshëm për autolarje.

6.Vendim mbi kërkesën e Shoqatës së invalidëve të Luftës së UÇK-së, dega në Obiliq për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1.500 euro, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Shoqatës së invalidëve të Luftës së UÇK-së, dega në Obiliq për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1.500 euro, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre.

7.Vendim mbi kërkesën e Xhevat Gërguri nga fshati Dardhishtë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1.000 euro, për shërim nga një sëmundje e rëndë.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Xhevat Gërguri nga fshati Dardhishtë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1.000 euro, për shërim nga një sëmundje e rëndë.

8.Vendim mbi kërkesën e Sahit Morinës nga fshati Hade i dërgohet DPUKP,dhe sektorit të bujqësisë për shqyrtim.

Me këtë vendim Kërkesa e Sahit Morinës nga fshati Hade i dërgohet DPUKP,dhe sektorit të bujqësisë për shqyrtim.

9.Vendim mbi Rregulloren për shërbimin e transportit me „ Marimange,, në territorin e Komunës së Obiliqit dhe Rregullorja për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme të Dalin në diskutim publik

Me këtë vendim Rregullorja për shërbimin e transportit me „ Marimange,, në territorin e Komunës së Obiliqit dhe Rregullorja për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme të dalin në diskutim publik

10.Vendimi mbi shqyrtimi e Planit të punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratuar Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

11.Vendim mbi kërkesës së Kryetarit të Komunës për sistemimin e mjeteve të bartura nga vitet e mëparshme.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës për sistemimin e mjeteve të bartura nga vitet e mëparshme.

12.Vendimi mbi Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2011.

Me këtë vendim miratohet Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2011.

13.Vendim mbi prolongimin e Projekt Rregullores për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme.

Me këtë vendim prolongohet Projekt Rregullores për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme.

14.Vendim mbi prolongimin e rregullores komunale për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taxi të udhëtarëve, lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e saj.

Me këtë vendim prolongohet plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores komunale për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taxi të udhëtarëve.

15.Vendim mbi festat e muajit qershor siç janë : 11 qershori, 14 qershori, dhe 29 qershori, të kremtohen në të njëjtën ditë dhe atë me dt. 14qershor- Dita e çlirimit të komunës .

Me këtë vendim festat e muajit qershor siç janë : 11 qershori, 14 qershori, dhe 29 qershori, të kremtohen në të njëjtën ditë dhe atë me dt. 14qershor- Dita e çlirimit të komunës .

16.Vendim mbi kërkesën e Shevqet Mjekiqit, anëtarë i klubit Kickbox në Obiliq të kompletohet me dokumentacionin përkatës siç është ftesa e organizatorit nga SHBA, njoftimi i Federatës së Kickboxit të Kosovës drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Me këtë vendim i kërkohet Shevqet Mjekiqit, anëtarë i klubit Kickbox në Obiliq të kompleton kërkesën me dokumentacionin përkatës siç është ftesa e organizatorit nga SHBA, njoftimi i Federatës së Kickboxit të Kosovës drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

17.Vendim mbi kërkesën e Betim Bregovinës nga Mazgiti i lartë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 80 Euro, për botimin e librit.

Me këtë vendim miratohet kërkesa e Betim Bregovinës nga Mazgiti i lartë për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 80 Euro, për botimin e librit.

18.Vendim mbi kërkesën e Jakup Grajqevcit përfaqësues i ish banorëve të fshatit Hade për ndërprerjen e kontratës nga ana e MMPH për kompensim të qirasë dhe ushqimit të këtyre qytetarëve kuvendi i komunës do ti bëjë shkresë të gjitha organeve relevante: Bordit të KEK-ut, MMHP dhe Qeverisë së Kosovës që ndihmat të vazhdojnë për këto familje deri sa të bëhet zgjedhja përfundimtare e vendosjes së këtyre familjeve.

Më këtë vendim miratohet kjo kërkesë.

19.Vendim mbi kërkesën e Shukri Mjekut nga Grabofci i Epërm për mbledhjen e ardhshme të kuvendit të komunës lidhur me pagesën e qirasë për banim.

Me këtë vendim Prolongohet kërkesa e Shukri Mjekut nga Grabofci i Epërm për mbledhjen e ardhshme të kuvendit të komunës lidhur me pagesën e qirasë për banim.

20.Vendim që të autorizohet ekzekutivi që ti shfrytëzoj të gjitha mundësit për ti ndihmuar familjes së Enver Krasniqit nga Breznica për ndërtimin e shtëpisë e cila ishte rrënuar nga bora.

Me këtë vendim autorizohet ekzekutivi që ti shfrytëzoj të gjitha mundësit për ti ndihmuar familjes së Enver Krasniqit nga Breznica për ndërtimin e shtëpisë e cila ishte rrënuar nga bora.

21.Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores komunale për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taxi të udhëtarëve.

Me këtë vendim u bë plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores komunale për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taxi të udhëtarëve.

Komuna e Dragashit

Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 1 rregullore dhe 5 vendime.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1. Rregullore mbi organizimin e Këshillit për Mirëmbajtjen e Sistemit të Ujësjetës si dhe shfrytëzimin e ujit të pijshëm nga ujësjetësi lokal i fshatit Brru.

Vendimet

1. Vendimin për dhënien e pëlqimit konzorciumit "Eurokos" për investime në hidrocentrale të vogla në lumenjtë e Brodit dhe Restelicë.

2. Vendimi për realizimin e buxhetit për vitin 2011.

3. Vendimi për iniciimin e procedurës për harmonizimin të Statutit të Komunës me dispozitat ligjore dhe formimin e komisionit që do të merret më këtë çështje.

4. Vendim mbi Raportin e Auditimit të Brendshëm të Komunës për vitin 2011.

Me këtë vendim është miratuar Raporti i Auditimit të Brendshëm të Komunës për vitin 2011

5. Vendim mbi kërkesën së NTP „Peleti,, për troll në ZI,, Dubrava,, dhe Themelimin e Komisionit.

Me këtë vendim NTP,, Peleti,, ju nda trualli dhe u themelua komisioni nga 5 anëtar.

Komuna e Lipjanit

Kuvendi i Komunës së Lipjanit gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 2 rregullore dhe 21 vendime.

Janar-Qershor 2012

Vendimet

1. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale 1N.413-755 të datës 03.12.2008.

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet kjo rregullore në disa nene.

2. Vendim për ndërrimin e ngastrave kadastrale në mes Komunës së Lipjanit dhe P.SH. Miniera e Magnezitit Golesh- AKP-së.

Ky vendim parasheh ndërrimin e ngastrave kadastrale në mes të komunës dhe AKP-së.

3. Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2010 dhe 2011 në vitin 2012, si dhe ridestinimin (transferin e mjeteve financiare) nga buxheti i vitit 2012 në mes të kategorive dhe programeve.

Me këtë vendim barten të hyrat vetanake të komunës të vitit 2010 dhe 2011 në vitin 2012 në kategoritë të caktuara.

4. Vendim për miratimin e buxhetit dhe shpenzimeve të Komunës së Lipjanit për vitin 2011.

Ky vendim parasheh miratimin e shpenzimeve të komunës për vitin 2011

5. Vendim për miratimin e raportit masat mobilizuese pas gjendjes emergjente dhe të jashtëzakonshme prej dt .25.01.2012 deri më 14.02.2012.

Me këtë vendim miratohet raporti i gjendjes së jashtëzakonshme.

6. Vendim për dhënien e tokës pasuri shoqërore K.K. Lipjan,KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhamin e fshatit Konjuh.

7. Vendim për dhënien e tokës pasuri shoqërore K.K. Lipjan,KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhamin e fshatit Banull.

8. Vendim për dhënien e tokës pasuri shoqërore K.K. Lipjan,KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhamin e fshatit Ribar i Vogël

Ky vendim parasheh dhënien e tokën pasuri shoqërore e komunës, Bashkësisë Islame në shfrytëzim për 10 vite.

9. Vendim mbi raporti i shpenzimeve dhe të hyrave të Komunës së Lipjanit për periudhën Janar-Mars 2012.

Me këtë vendim u miratua raporti i shpenzimeve dhe të hyrave të Komunës së Lipjanit për periudhën Janar-Mars 2012.

10. Vendim mbi Rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratuar Rishikimi i buxhetit për vitin 2012.

11. Vendim për Riparcializim të ngastrave kadastrale në mes Komunës së Lipjanit dhe Besim Bislimit dhe Gani Kadrijaj nga Lipjani.

Me këtë vendim i rekomandohet ekzekutivit që ta bëjë Riparcializimin e ngastrave kadastrale në mes Komunës së Lipjanit dhe Besim Bislimit dhe Gani Kadrijaj nga Lipjani

Komuna e Podujevës

Kuvendi i Komunës së Podujevës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 1 rregullore dhe 13 vendime.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për përcaktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfero.

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfero.

Vendimet

1.Vendim për riemërimin e paluejtshmërive në pronësi të komunës

Me këtë vendim ndryshohet emërtimi nga prona shoqërore komunale në pronë komunale

2 . Vendim për vënien në diskutim publik të vendimit për caktimin e linjave urbane, urbano - periferike dhe orarin e qarkullimit

Ky vendim parasheh vënien në diskutim publik të këtij vendimi.

3. Vendim për emërtimin “Sheshit të Dëshmoreve” dhe vendosjen e Monumentit tre Heronjve të Kosovës.

Me këtë vendim emërtohet “ Sheshi i Dëshmoreve” dhe vendosja e Monumentit të tre Heronjve të Kosovë

4.Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Podujevës

Ky vendim parasheh ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës në nenet e caktuara.

5.Vendim për dhënien e paluejtshmërisë në pronësi të Komunës për shfrytëzim të përhershëm Ministrisë të Punëve të Brendshme

Me këtë vendim, vendoset për dhënien e paluejtshmërisë në shfrytëzim të përhershëm MPB, për ndërtimin e objektit të përbashkët, për nevoja të qytetarëve.

6.Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Podujevës

Ky vendim parasheh ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës

7.Vendim për iniciimin e procedurës për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me paluajtshmërinë e pronësisë shoqërore të K. B. " Drita" ZK. Shajkoc

Me këtë vendim fillohen procedurat për iniciimin e procedurave për këmbim të pronës

8.Vendim për lejimin e iniciimit të procedurave për dhënien e paluajtshmërisë në pronësi të komunës në shfrytëzim afat shkurtër

Me këtë vendim lejohej iniciimi i procedurave për dhënien e paluajtshmërisë pronë e komunës

9 . Vendim për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit

Me këtë vendim caktohet rrjeti i linjave urbane,urbano-periferike,vendbanimeve rurale,pikat e stacioneve , vend ndaljet dhe oraret e nisjeve të operatorëve në trafikun në territorin e Komunës së Podujevës.

10 . Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2011 në vitin 2012 dhe destinimi në kateterit të caktuara buxhetore

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës, të pashpenzuara në vitin 2011, në shumën 285.532,26 € barten në vitin 2012

11.Vendimi mbi rishikimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2012.

Me këtë vendim bëhet rishikimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2012.

12 .Vendimi për miratimin e Projekt Planit Rregullues Urban Qendra në Podujevë

Me këtë vendim miratohet Projekt Planit Rregullues Urban Qendra në Poduje

13. Vendim mbi planin Lokal të Veprimit në Medis

Me këtë vendim miratohet Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.

Komuna e Ferizait

Kuvendi i Komunës së Ferizait gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 11 vendime.

Janar-Qershor 2012

Vendimet

1. Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të kuvendit gjatë vitit 2012;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar propozim buxhetin e komunës si dhe projeksionet buxhetore për periudhën 2012-2014.

2. Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për të hyra vetanake të komunës 01 nr. 6580 të datës 09.12.2008;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për të hyra vetanake të komunës 01 nr. 6580 të datës 09.12.2008;

3. Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2011;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2011 si dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore për vitin fiskal 2012 në vlerë prej 860.066.55 euro.

4. Vendimi për dhënien në diskutim publik të projekt rregullores për ndarjen e subvencioneve;

Më këtë vendim kuvendi ka kaluar në diskutim publik projekt rregulloren për ndarjen e subvencioneve

5. Vendim për hartimin e planit rregullues “Zona 8”.

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar hartimin e planit rregullues Zona 8 i cili plan është hartuar në harmoni me kushtet e përcaktuara nga PZHK si dhe definon kushtet teknike urbane në bazë të standardeve për rregullimin e hapësirës.

6. Vendim për hartimin e planeve rregulluese për zonat 3,6 dhe 7;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për fillimin e hartimit të planeve rregullative urbane për zonat 3, 6 dhe 7 të përcaktuara në bazë të Planit zhvillimor urban.

7. Vendim për hartimin e planit zhvillimor urban me elemente të planit rregullues për qendrën sekondare Softaj;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për plotësimin e hartimit të planit zhvillimor urban me elemente të planit rregullues për qendrën sekondare Softaj;

8. Vendim për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore për ngastrat; 320,322,323, ZK Gërlicë e Poshtme;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore për ngastrat; 320,322,323, ZK Gërlicë e Poshtme;

9. Vendim për miratimin e raportit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2011;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar hartimin e planit rregullues Zona 8 i cili plan është hartuar ne harmoni me kushtet e përcaktuara nga PZHK si dhe definon kushtet teknike urbane në bazë të standardeve për rregullimin e hapësirës.

10 .Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2012, në te cilin rishikim janë paraparë disa ndryshime të projekteve

11 Vendim për rritjen e buxhetit

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar rritjen e të hyrave vetanake të vitit fiskal 2012 në vlerë prej 400.000 euro

Komuna e Istogut

Kuvendi i Komunës së Istogut gjatë periudhës janar - qershor 2012 ka miratuar 13 vendime, edhe 2 rregullore.

Janar-Qershor

Rregulloret

1. Rregullorja për përdorimin e zutomjeteve zyrtare

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë të drejtën e përdorimit të rregullt, ekonomik dhe efikas të automjeteve të Komunës.

2.Rregullorja për transparencën komunale.

Kjo Rregullore ka për qëllim rritjen e transparencës në punë të organeve të Komunës së Istogut: Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës, dhe organeve të Administratës, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.

Vendimet

1.Vendim për themelimin e Komisionit për monitorimin e punës së komisioneve që kanë vlerësuar dëmet e erës së 6 dhe 7 janarit.Me këtë Vendim, formohet Komisioni për verifikimin e shpërndarjes së ndihmave, përkatësisht tjegulla personave në nevojë.

2.Vendim për shpërndarjen e mjeteve të bartura nga viti 2011 në vitin 2012.Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve në planin e buxhetit komunal të vitit 2011 në shumë të përgjithshme prej 270,007.64 euro.

3.Vendim për Rritjen e planit të hyrave vetanake për vitin 2012.

Me këtë Vendim, miratohet rritja e të hyrave vetanake në planin e buxhetit komunal të vitit 2012 në shumë të përgjithshme prej 45.005.82 euro.

4.Vendim për hedhjen në diskutim publik Projekt-Rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Me këtë Vendim hapet diskutim publik për projekt-rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.

5.Vendim për shfuqizimin e Rregullores për dhënien e lejes së punës subjekteve afariste në Komunën e Istogut.

Me këtë Vendim, shfuqizohet Rregullorja për dhënien e lejes së punës subjekteve afariste në Komunën e Istogut në tërësi, për shkak se kjo çështje është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për tregtinë e Brendshme nr.2004/07(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 5/2011).

6.Vendim për shfuqizimin e Rregullores mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe mëditjeve.

Me këtë Vendim, shfuqizohet Rregullorja mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe mëditjeve në tërësi, për shkak se kjo çështje është e rregulluar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPLS-së nr.2004/07, për udhëtimet zyrtare.

7.Vendim për hedhjen në diskutim publik të Projekt-Rregulloren për transparencën komunale.

Me këtë Vendim, hapet diskutim publik për Projekt-Rregulloren për Transparencën.

8.Vendim për ridestinimin e projekteve komunale.

Me këtë Vendim, me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga era të gjithë qytetarëve, bëhet ridestinimi i mjeteve nga projektet kapitale në programet buxhetore të cilat janë paraqitur në vijim të propozim vendimit.

9. Vendim për miratimin e Raportit financiar të vitit 2011.

Me këtë Vendim, miratohet Raporti financiar për vitit 2011.

10.Vendim për shpalljen në diskutim publik, të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

Me këtë Vendim, shpallet në diskutim publik Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.

11.Vendim për miratimin e rishikimit të Buxhetit Komunal për vitin fiskal 2012.

Me këtë vendim, miratohet Rishikimi i buxhetit komunal të vitit 2012 pa vërejtje.

12. Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

Me këtë Vendim, miratohet Plani Lokal i Veprimit në Mjedis pa vërejtje

13.Vendim për hedhjen në diskutimi publik të Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Istogut.

Me këtë Vendim hedhet në diskutim publik Projekt-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Istogut.

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës së Klinës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 21 vendime dhe 1 rregullore.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1. Miratimi i Rregullores për Komitetet Konsultative.

Me këtë rregullore, rregullohet puna e komiteve konsultative në komunën e Klinës

Vendimet

1.Vendim për shqiptimin e masës së pezullimit më shumë se një muaj të 22 nxënësve të shkollave të mesme të larta në Klinë, si dhe organizimi i arsimimit alternativ të tyre.

Me këtë Vendim bëhet shqiptimi i masës së pezullimit të shkollave të mesme të larta në Klinë, si dhe organizimi i arsimimit alternativ për këta nxënës.

2.Vendim për lëshuarjen në diskutim publik të Projekt-Rregullores për Komitetet Konsultative.

Me këtë Vendim, lëshohet në diskutim publik Projekt-Rregullorja për Komitetet Konsultative.

3.Vendim për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores komunale për përcaktimin e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale, dhjetor 2008.

Me këtë Vendim, miratohen ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores komunale për përcaktimin e ngarkesave dhe taksave komunale, dhjetor 2008.

4.Vendim për miratimin e preferencave të Komitetit për Politikë dhe Financa të dt:16.01.2012.

Me këtë Vendim, miratohen në tërësi preferencat e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt:16.01.2012.

5.Vendim për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake dhe destinimin e tyre.

Me këtë Vendim, buxheti i planifikuar nga të hyrat për vitin 2011 është tejkaluar për 101, 723.11 €. Planifikimi i buxhetit nga të hyrat ka qenë 630,000.000 €, kurse janë realizuar 731,723.11 €.

6. Vendim mbi miratimi e preferencave të KPF-së.

Me këtë vendim miratohen preferencat e Komitetit për Politik dhe Financa.

7. Vendimi mbi miratimin e Rekomandimeve të Procesverbalit të takimit me publikun (takimi i II-të) 27.12.2011

Me këtë vendim miratohen Rekomandimet të Procesverbalit të takimit me publikun (takimi i II-të) 27.12.2011.

8. Vendim mbi miratimin e Planit të punës së zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratua Plani i punës së zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2012.

9. Vendim mbi miratimin e Planit të punës së Prokurimit për vitin 2012.

Me këtë vendim u miratua Plani i punës së Prokurimit për vitin 2012.

10. Vendim për iniciimin e procedurës për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban të vitit 2005-2015.

Me këtë vendim u miratua iniciimi i procedurës për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban të vitit 2005-2015.

11. Vendim për miratimin e Projekt-Rregullores për Komitetet Konsultative të Komunës së Klinës.

Me këtë Vendim, miratohet Projekt-Rregullorja për Komitetet Konsultative në Komunën e Klinës.

12. Vendim për miratimin e preferencave të KPF-së

Me këtë Vendim, miratohen Preferencat e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.19.03.2012 në tersi.

13. Vendim për miratimin i Organogramit komunal për vitin 2012;

Me këtë Vendim, miratohet Organogrami-skema e organizimit të brendshëm të Komunës për vitin 2012.

14. Vendim për miratimin e Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2011.

Me këtë Vendim, miratohet Raporti si në pikën një të këtij vendimi me vërejtje dhe sygjerrime nga anëtarët e Kuvendit.

15. Vendim për fillimin e procedurave të shitblerjes së banesave në pronësi publike-komunale.

Miratohet vendimi për Inicimin e procedurave të shitblerjes së banesave në pronësi publike komunale. Inicimi i procedurës si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në harmoni me ligjet në fuqi.

16. Vendim për Inicimin e procedurës për ndryshimin e Statutit të QKMF-së dhe formimin e komisionit për ndryshimin e Statutit.

Miratohet vendimi par Inicimin e procedurës për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të QKMF-së si dhe formimi i Komisionit profesional par ndryshime të Statutit.

17. Vendim për miratimin e preferencave të KPF-së.

Me këtë Vendim, miratohen në tanësi preferenca e KPF-së të dates: 17.04.2012.

18. Vendime për miratimin e Raportit Financiar të Komunës për periudhën janar-mars 2012.

Me këtë Vendim, miratohet Raporti Financiar I Komunës për periudhën janar-mars 2012, me vërejtjet dhe sygjerrimet në kategorinë mallra dhe shërbime.

19. Vendim për miratimin e rekomandimit të preferencës së KPF-së.

Me këtë Vendim, miratohen rekomandimi i preferencës së KPF-së me rekomandimet e dhëna.

20. Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

Me këtë Vendim, bëhen përshtatjet në pozicionet buxhetore të Komunës së Klinës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012.

21. Vendim për miratimin e preferencave së KPF-së të dt: 11.06.2012

Me këtë Vendim, miratohen preferencat së KPF-së të dt:11.06.2012.

Komuna e Pejës

Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 27 vendime .

Janar-Qershor 2012

Vendimet

1. Vendim për miratimin e Kalendarit të takimeve të KPF-së dhe KK.Pejë për vitin 2012.

Me këtë Vendim, miratohet kalendari I takimeve KPF-së dhe KK.Pejë për vitin 2012, siq u është prezantuar anëtarëve të Kuvendit me material për Takim.

2. Vendim për bartjen e fondeve të pa shfrytëzuara nga viti 2011 në vitin 2012.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi I Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Kryetarit të Komunës, për bartjen e fondeve të pa shfrytëzuara nga viti 2011 në vitin 2012.

3. Vendim për shpërndarjen e mjeteve nga tejkalimi i Planit Buxhetor të vitit 2011 në kategori ekonomike sipas prioriteteve të Komunës.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi I Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Kryetarit të Komunës, për shpërndarjen e mjeteve nga tejkalimi i Planit Buxhetor të vitit 2011 në kategori ekonomike sipas prioriteteve të Komunës.

4. Vendim për shpalljen në shqyrtim public të project-Planit Rregullues Urban të B.T “Xhemajl Kada-7 Shtatori”.

Me këtë Vendim, shpallet në shqyrtim public, Projekt-Plani Rregullues Urban të B.T “Xhemajl Kada-7 Shtatori”.

5. Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm vendosja e varrezave të fshatit Trstenik në hapësirën prej 02.00,00 ha, të ngast.kad.nr.214/59 P.Sh. KBI.Pejë.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi I Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike, për shpalljen më interes të përgjithshëm(interess public) ndarja e hapsirës në sipërfaqe prej 02.00,00 ha,(dy hektar), nga sipërfaqja e përgjithshme prej 13.39,90 ha, e ngast.kad.nr.214/59, Zona kadastrale Trestenik, evidentuar sipas Fl.pos.nr.109, si pronë shoqërore e ish Kombinatit Bujqësor Industrial në Pejë, që administrohet nga AKP-ja, për destinim-ndërrim të varrezave të fshatit Trestenik Komuna e Pejës.

6. Vendim për ndarjen e truallit në sipërfaqe prej 01.00,00 ha, nga nast.kad.nr.105/1 dhe 105/2 pronë e Komunës së Pejës, Z.K Zagërme, për varreza të fshatit Raushiq KK.Pejë.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi I Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike, për ndarjen e truallit në sipërfaqe prej 01.00,00 ha, nga sipërfaqja e përgjithëshme e ngast.kad.nr.105/1 dhe ngast.kad.nr.105/2, pronë komunale, Zona kadastrale Zagerme, e evidentuar sipas Fl.pos.nr.60, që gjendet në fshatin Zagërme KK.Pejë, për vendosjen -ndërtimin e varrezave të fshatit Raushiq të K.KPejë.

7. Vendim për ndërrim të pozicionit të rrugës sipas fletëposedimit nr.171-0 pronë komunale me ngast.kad.nr.104/1 dhe 104/2 pronë private në sipërfaqe relativisht të njëjtë.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi për dislokim -ndërrim të pozicionit të rrugës publike, nga pozicioni më I parshëm I ngast.kad.nr.171-0, pronë komunale që është e pa shfrytëzueshme, në lokacion që përfshinë ngast.kad.nr 104/1 dhe ngast.kad.nr 104/3 pronë private-qirambajtje për 99 vite, nga z.Metë(Sadri) Ahmeti, nga f.Ramunë KK.Pejë, dhe këmbim të këtyre pronave me sipërfaqe përafërsisht të njëjtë, e me qëllim të zgjidhjes së problemit të rrugës, për qarkullim të lirë të qytetarëve, gjegjësisht Çështjes së hapjes së rrugës publike në atë pjesë.

8. Vendim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit për anëtarë të Grupit Punues të programit të përbashkët me DEM-in për regjistrimin e pronave komunale.

Me këtë Vendim, caktohen nga radhët e anëtarëve të kuvendit për anëtarë të Grupit Punues të Programit të përbashkët me DEM-in për regjistrimin e pronave Komunale.

9. Vendim për miratimin e propozimit për përshtatjen buxhetore - transferi i ndarjeve buxhetore nga Grandi Qeveritar dhe të hyrat vetanake sipas kërkesës së parashtruar në shumë prej 71,150.00 nga investimet kapitale në mallra dhe shërbime në të njëjtin program-Zyra e Kryetarit.

10.Vendim për miratimin e Propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës për fillimin e procesit të punës në hartimin e Planit Rregullues Urban për fshatin Bogë KK.Pejë.

Me këtë Vendim miratohet e Propozimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës për fillimin e procesit të punës në hartimin e Planit Rregullues Urban për fshatin Bogë KK.Pejë, nga mjetet e planifikuara Buxhetore të vitit 2012.

11. Vendim për miratimin e Propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës për fillimin e procesit të punës në hartimin e Planit Rregullues Urban të quajtur zonës EST në Pejë.

Me këtë Vendim, miratohet Propozimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës për fillimin e procesit të punës në hartimin e Planit Rregullues Urban të quajtur "Zonës EST" në Pejë, nga mjetet e planifikuara Buxhetore të vitit 2012.

12. Vendim për miratimin e propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës, për fillimin e procesit për rishikimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Pejës, si obligim ligjor që duhet çdo 5 vite konform Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës, për fillimin e procesit për rishikimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Pejës, si obligim ligjor që duhet çdo 5 vite konform Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor, nga mjetet e planifikuara Buxhetore të vitit 2012.

13. Vendim për aprovimin e Planit Rregulluese Urbane për: B.T. "Kapeshnica-Puhovci".

Me këtë Vendim, në pajtim me aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Pejës nr.01-350-4999 datë 14.05.2007, aprovohet Plani Rregullues Urban për B.T. "Kapeshnica-Puhovci".

14. Vendim për aprovimin e Planit Rregulluese Urbane për: B.T. "Puhovci-Jarina".

Me këtë Vendim, në pajtim me aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Pejës nr.01-350-4999 datë 14.05.2007, aprovohet Plani Rregullues Urban për B.T. Asllan Qeshme-Jarinë projekti "Puhovci-Jarin".

15. Vendim për aprovimin e Planit Rregulluese Urbane për: B.T. Jarina-Xhemajl Kada".

Me këtë Vendim, në pajtim me aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Pejës nr.01-350-4999 datë 14.05.2007, aprovohet Plani Rregullues Urban për B.T. Jarina-Xhemajl Kada".

16. Vendim për miratimin e miratimin e Propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetarit të Komunës, për fillimin e punës në hartimin e Planit Rregullues Urban për B.T. "Dardania" në Pejë.

17. Vendim për miratimin e propozimit të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve , Rrugicave dhe vendeve tjera publike.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi i Komisionit Komunal për emërtime dhe riemërtime si dhe vendosja e shtatores si vijon në vendim.

18.Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm shpronësimi i hapësirës në gjerësi prej 1,5 m. të ngastrave kadastrale të skicuara dhe paraqitura në tabelë për realizimin e projektit të Rregullimit të shtegut unazor rekreativ për ecje dhe çiklizëm të financuar 90%nga Komisioni European.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi për shpalljen me interes të përgjithshëm -publik realizimi I Projektit për rregullimin e Shtegut Unazor rekreativ për ecje dhe çiklizëm të financuar 90%nga Komisioni European dhe 10% nga Komuna.

19. Vendim për ndarjen e truallit z.Ramë Dervish Ukaj, nga Peja, invalid i luftës së UÇK-së, për ndërtimin e shtëpisë si rast i rëndë social.

Me këtë Vendim, z.Ramë Dervish Ukaj nga Peja, invalid i luftës së UÇK-së, I ndahet në shfrytëzim truall pronë komunale në sipërfaqe 0.03,20 ha, nga sipërfaqja e përgjithëshme e pronës së evidentuar sipas fletë posedimit Nr.504, ngast.kad.305 zona kadastrale Belo Pojë KK-Pejë, në sipërfaqe të përgjithëshme 0.17,14 ha, me kulturë arë e klasit të 4 , konform skicës së lëshuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi e KK.Pejë, për ndërtimin e objektit të banimit familjar si rast I rëndë social.

20 Amendament mbi ndryshimin dhe plotësimin e Amendamenteve në Statutin e Komunës së Pejës.

Me këtë amandament bëhen ndryshime dhe plotësimet të Amandamentit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Pejës, 01 Numër:020-1163, të datës 15 shkurt 2012. Te neni 3 kapitulli X: Drejtoritë Komunale, te ndryshimet e bëra në nenin 87 paragrafi 6 “Zyra për Komunitete”, ndryshohet dhe titullohet ‘Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim”.

21.Vendim për miratimin e propozimit të Drejtorisë për Çështje Pronëso-ro-Juridike për anulimin dhe shpalljen të pavlefshme të 35 Aktvendimeve mbi ndarjen e trojeve-pronë komunale në shfrytëzim, të nxjerra nga ish Kuvendi Komunal në periudhën 1998, në kundërshtim me Ligjin mbi tokën ndërtimore dhe Ligjin mbi Procedurën Administrative dhe arsye të tjera të cekura në Projekt-Vendimin mbi shfuqizim.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi I Drejtorisë për Çështje Pronëso-ro-Juridike të Komunës së Pejës, dhe shpallen akte të pavlefshme në të gjitha pikat këto aktvendime mbi shfrytëzimin e përhershëm.

22. Vendim për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2012.

Me këtë Vendim, miratohet rishikimi I Buxhetit Komunal Pejë për vitin 2012, sipas kërkesave të programeve të paraqitura nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

23. Vendim mbi shpalljen në diskutim publik të Amendament për ndryshim dhe plotësim në Statutin e Komunës së Pejës, I. Nr.01-06-3608 datë 30 prill 2012.

Me këtë Vendim, hapet diskutim public për ndryshimin dhe plotësimin e Amendamentit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Pejës, 01. Numër:020-1163 date: 15 shkurt 2012, dhe atë: ndryshim të emërimit të "Drejtorisë për Sigurimin e Investimeve të Jashtme" dhe titullimin e saj" Drejtoria për Integritet dhe Diasporë.

24. Vendim për miratimin e kërkesës për rimbursim të Buxhetit Komunal -Pejë.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa për Rimbursim të Buxhetit Komunal Pejë, me mjete shtesë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

25. Vendim për hedhjen në diskutim publik të Projekt Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Pejës.

Me këtë Vendim, hedhet në diskutim publik Projekt-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Pejës.

26. Vendim për formimin e Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e këshillave të Bashkësive Lokale.

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e këshillave të Bashkësive Lokale.

27. Vendim për miratimin e kërkesës së Drejtorisë për Administratë dhe Koordinatorit të Grupit Punues për implementimin e Projektit "Parku Memorial I Pavarësisë", propozimit për dislokimin e përmendores egzistuese të revolucionit socialist nga vendi actual -"Parku Garagaq-Pejë", në lokacionin te Maja e Zezë dhe vendosja e një përmendoreje të lirisë sipas projektit të ri.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Drejtorisë për Administratë dhe Koordinatorit të Grupit Punues për implementimin e Projektit "Parku Memorial I Pavarësisë", propozimit për dislokimin e përmendores egzistuese të revolucionit socialist nga vendi actual -"Parku Garagaq-Pejë", në lokacionin te Maja e Zezë dhe vendosja e një përmendoreje të lirisë sipas projektit të ri.

Komuna e Malisheves

Kuvendi i Komunës së Malishevës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 19 vendime .

Janar-Qershor 2012

Vendimet

1. Vendim për ndarjen e një sipërfaqe tokësore, për qëllim të rregullimit të varrezave publike të Qytezës së Malishevës.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/125 e datës 18.01.2012, për inicimin e procedurave për ndarjen e një sipërfaqe tokësore, për qëllim të rregullimit të varrezave publike të Qytezës së Malishevës, në sipërfaqe prej 1.50.00 ha.

2. Vendim në lidhje me kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë nr.01/119 datë 11.01.2012, për ndarjen e një sipërfaqe tokësore, për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Drenoc.

Me këtë Vendim miratohet kërkesa e Kryesisë së fshatit Drenoc nr.01/1555 datë:01.12.2012, si dhe kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë nr.01/119 datë 17.01.2012, për ndarjen e një sipërfaqe tokësore për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Drenoc, në sipërfaqe prej 0.04.ha.

3. Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.01/205 datë 23.03.2004 për shpalljen e zonës së veçantë dhe caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë së kulturës.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e kryetarit të Komunës nr.01/134 e datës 20.01.2012, për shfuqizimin e vendimit nr.01/205 datë 23.03.2004 për shpalljen e zonës së veçantë dhe caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë së kulturës.

4. Vendim për formimin e Komitetit për Diasporë.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa nr.02/01 e datës 05.01.2012 e parashtruar nga Grupi Parlamentar I LDK-së, për formimin e Komitetit të Diasporës.

5. Vendim për formimin e Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteranë të UÇK-së

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa nr.02/01 e datës 05.01.2012 e parashtruar nga Grupi Parlamentar I LDK-së, për formimin e Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteranë të UÇK-së

6. Vendim për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa nr.02/01 e datës 05.01.2012 e parashtruar nga Grupi Parlamentar I LDK-së, për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

7.Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në emër të katër familje të dëshmorëve të Komunës së Malishevës të rënë jashtë kufijëve të Republikës së Kosovës.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/313 datë, 20.02.2012, si dhe kërkesa nr.02/38 e datës 23.02.2012 e parashtruar nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, dega në Malishevë për ndarjen e mjeteve financiare për katër familjet e Dëshmorëve të cilët nuk e kanë të rregulluar statusin e familjes së Dëshmorit.

8.Vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga buxheti i vitit 2011, në buxhetin e vitit 2012.

Me këtë Vendim, miratohet bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga buxheti i vitit 2011, në buxhetin e vitit 2012 në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në programin e arsimit(920), në programin e shëndetësisë(730) dhe në bashkëfinancim me qytetarë.

9.Vendim mbi miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

Me këtë Vendim, miratohet propozimi I Komisionit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2012.

10.Vendimin për Formimin e Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit në përbërje prej 9 anëtarëve.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/371 e datës 16.03.2012 për formimin e Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit për Komunën e Malishevës në përbërje prej 9 anëtarëve.

11. Vendimin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/372 të datës 16.03.2012 për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Malishevës.

12. Vendimin për harmonizimin e planit zhvillimor komunal urban, Malisheva 2004-2014, me ligjin për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/373 e datës 16.03.2012, për harmonizimin e Planit Zhvillimor Urban, miratuar në asamblenë Komonale në mbledhjen e mbajtur me datë:19.11.2004(Malisheva 2004-2014 Vendimi nr.01/543 datë 15.12.2004 me Ligjin për Planifikim Hapësinor).

13.Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e muzeut të Komunës së Malishevës.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/422 datë 04.04.2012, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e muzeut të Komunës së Malishevës.

14. Vendim për miratimin e Planit të Reagimit për Komunën e Malishevës.

Me këtë Vendim, miratohet project-propozimi I Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, për Planin e reagimit për Komunën e Malishevës.

15. Vendim për formimin e Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 qershorit ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Me këtë Vendim miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/541 e datës 16.05.2012, për formimin e Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 qershorit ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

16. Vendim për kushtëzimin e lëshimit të vërtetimit të Tatimit në Pronë për Regjistrimin e Automjeteve.

Me këtë Vendim, miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës nr.01/557 datë 21.05.2012, për kushtëzimin e lëshimit të vërtetimit të tatimit në pronë, me rastin e regjistrimit të automjeteve për përfituesit e shërbimeve nga "Ekoregjioni" dhe "Hidroregjioni" njësia në Malishevë.

17. Vendim për ndryshimin e Çmimit për Trimëri dhe Heroizëm "Imer Krasniqi".

18. Vendim për ndryshimin e Çmimit për kontribut në shkollën Shqipe "Hamdi Berisha".

19. Vendim për ndryshimin e Çmimit për kontribut në shëndetësi "Shpëtim Robaj".

Komuna e Suharekës

Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë periudhës janar - qershor 2012 ka miratuar 20 vendime dhe 1 rregullore.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1. Rregullorja për punën e grupit të grave anëtare të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Me këtë Rregullore përcaktohet kompetenca, organizimi i punës dhe mënyra e funksionimit të Grupit të Grave anëtare të Kuvendit të Komunës, pa dallim feje, race dhe etniteti.

Vendimet

1. Vendim mbi miratimin e planit rregullues në lagjen “Pojata” në Suharekë;

Më këtë vendim, miratohet plani rregullues urban i reviduar për lagjen “Pojata” në Suharekë për periudhën 2012-2017, në sipërfaqe të përgjithshme 34.38,00ha, zona kadastrale Suharekë.

2. Vendim mbi miratimin e planit rregullues në lagjen “Shirok” në Suharekë;

Më këtë vendim, miratohet plani rregullues urban i reviduar për në pjesë të lagjes “Shiroka” të Suharekës për periudhën 2012-2017, në sipërfaqe të përgjithshme 37.76,00ha, zona kadastrale Shpijë.

3. Vendim mbi formimin e komisionit;

Më këtë vendim, formohet komisioni për krijimin e kushteve për implementimin e PRRU në komunën e Suharekës.

4. Vendim për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien në shfrytëzim afat shkurtër të pronës komunale;

Më këtë vendim, jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 (dhjetë) vite të pronës komunale.

5. Vendim mbi plotësim-ndryshim të këshillit të ekspertëve për PZHK,PZHU dhe PRRU;

Më këtë vendim, bëhet plotësim-ndryshimi i këshillit të eksperteve të planifikimit si organ këshillëdhënës dhe grupin për mbikëqyrje dhe koordinim

6. Vendim për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e tenderimit për projektin me PPP-në.

Më këtë vendim, jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien e shërbimeve komunale të projektit “ Koncesionimin e shërbimeve të mbledhjes dhe veçimit të mbeturinave në tërë teritorin e komunës së Suharekës” përmes partneritetit publiko-privat siç përcaktohet në Ligjin e Partneritetit Publiko Privat dhe Direktivat përkatëse të KPPP-së.

7. Vendimi për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

Më këtë vendim, jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien në shfrytëzim afat-shkurt deri në 10(dhjetë) vite të pronës komunale.

8. Vendim për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2011.

9. Vendim për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2010 dhe 2011, të përcillen për shfrytëzim në vitin 2012.

Më këtë vendim, bëhet bartja dhe alokimi i mjeteve vetanake të vitit 2010 dhe 2011 dhe përcillen për shfrytëzim në vitin 2012.

10. Vendim për bartjen dhe alokimin e mjeteve nga donatorët e brendshme të vitit 2011, të përcillen për shfrytëzim në vitin 2012.

Më këtë vendim, bëhet bartja e alokimi i mjeteve nga donatorët e brendshëm të vitit 2011 dhe përcillen për shfrytëzim në vitin 2012.

11. Vendim për miratimin e raportit të menaxhimit financiar të buxhetit të Komunës në Suharekë.

Me këtë Vendim, miratohet raporti i menaxhimit financiar të buxhetit të Komunës në Suharekë.

12. Vendim për miratimin e rekomandimit të komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënin në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me këtë Vendim, miratohet rekomandimit i komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënin në shfrytëzim afat shkurtër deri në (10) vjet të pronës së paluajtshme të Komunës në sipërfaqe prej 200 m² z. Sali Pirku për ushtrimin e veprimtarisë së zdrukthëtarit.

13. Vendim për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 vite të pronës së paluajtshme të Komunës;

Me këtë Vendim, jepet në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 vite, prona e paluajtshme e Komunës, për ndërtimin e objektit administrativ për KRU "Hidroregjioni Jugor" njësia në Suharekë, parcela nr-2784/1, P-72116046-02784-1, sipas certifikatës nr-421, me sipërfaqe prej 0.13,00ha, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur "Gradina/Straqi Noga" nga parcela e përgjithshme me sipërfaqe prej, 109592 ha, pasuri e Komunës në Suharekë, kjo parcelë i jepet Ministrisë për Zhvillim Ekonomik në Prishtinë..

14. Vendim për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedura të tenderit për dhënien në shfrytëzim afat shkurt të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me këtë Vendim, jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10(dhjetë) vite të pronës komunale të Komunës.

15. Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimeve për ndarje e çmimeve për nder të "13 qershorit" ditës së çlirimit të Suharekës

Me këtë Vendim, emërohet Komisioni për nominimin e propozimeve që vijnë nga ana e qytetarëve, institucioneve , shoqatave, kryesive të fshatrave për dhënien e

shpërblimeve “Emblema e Artë”, “Skëndërbeu”, dhe mirënjohjes “13 Qershori” për nder të “13 qershorit” ditës së çlirimit të Suharekës, në përbërje prej 7 anëtarëve.

16Vendim, me të cilin AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës, që të fillon konsultimet për themelimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër-kombëtar, (binjakëzimit) në mesë Bashkisë së Sarandës të Republikës së Shqipërisë dhe Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës.

17. Vendim mbi miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë” dhe mirënjohjen “13 Qershori”

Me këtë Vendim, shpërblimi “Emblema e artë” i ndahet veprimtarit, Shaban Mazrreku (postmortum) nga fshati Sopijë, mirënjohja “13 Qershori” i ndahet këtyre të nominuarëve: 1. Shaban N. Ndrecaj nga fshati Maqitevë, 2. Mehmet Suka nga fshati Bllacë, 3. Demir Kabashi nga fshati Dardhishtë e Ulët, 4. Jahir Buzhala nga fshati Budakovë, 5. Liman Sopa nga fshati Bukosh, 6. Ragip Haziraj nga fshati Gjinoc, 7. Jahir Palushi nga fshati Budakovë, 8. Rifat Izlam Lushaj nga fshati Greikoc, 9. Asllan Shala nga Suhareka, 10. Fazli Kabashi fshati Studenqan, 11. Xhavit Mala nga fshati Mushtisht, 12. Behxhet Berisha nga Suhareka dhe 13. Hamzi Berisha nga Suhareka.

18. Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

Me këtë Vendim, Komuna e Suharekës konform dispozitave ligjore të aplikueshme dhe sipas njoftimit të Ministrisë së Financave në Prishtinë, bënë rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2012, në këto programe të komunës nga kategoria e shpenzimeve kapitale e hyrave vetanake të vitit 2012, shuma e mjeteve financiare 135.000,00€, transferohet në Arsimit dhe Shkencë (920)-në **sub programi Arsimit fillor 920-93330** në kategorinë e pagave dhe mëditjeve

19. Vendim për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 vite të pronës së paluajtshme të Komunës;

Me këtë Vendim, jepet në shfrytëzim afat shkurtër deri në 10, (dhjetë) vite, ngastrat kadastrale Nr-333/2 në sipërfaqe prej 21194m², UL-72116029-00768, në vendin e quajtur, “Ravshina” sipas certifikatës Nr-317, zona kadastrale Mushtisht dhe Objektet e faktikes 3 (tri) kafshe me mjetet themelore të cilat gjinden në ato objekte e ndërtuar në parcelat e cekura më lartë, në emër të pasurisë shoqërore Kuvendi Komunal në Suharekë, për ushtrimin e veprimtarisë, sipas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin e ofertave.

20.Vendim për dhënien në shfrytëzim afat shkurt deri në 10 vite të Lokalit afarist.

Me këtë Vendim, jepet në shfrytëzim afate shkurt deri në 10, (dhjetë) vite, Lokali afarist i cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, të ndërtesa e kaltër me sipërfaqe të përgjithshme prej 93.84m², në emër të pasurisë shoqërore Kuvendi Komunal në Suharekë, për ushtrimin e veprimtarisë sipas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin e ofertave.

Komuna e Gllgocit

Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 4 vendime .

Janar-Qershor 2012

Vendimet

- 1.Vendim për rritjen e të hyrave vetjake**
- 2.Vendim për bartjen e te hyrave vetanake.**
- 3.Vendim për financimin e projektit.**
- 4.Vendim për ndarjen e banesës familjes Berisha nga fshati Vasilevë.**

Komuna e Mitrovicës

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 14 vendime dhe 3 rregullore .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

- 1.Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Mitrovicës.**
- 2. Rregullore për trajtimin e ndërtimeve pa leje**
Me këtë Rregullore, rregullohet trajtimi i ndërtimeve pa leje.
- 3. Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.**
Me këtë Rregullore, rregullohen taksat komunale, ngarkesat dhe gjoba

Vendimet

1.Vendim, për miratimin e Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve komunale.

2.Vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

3.Vendim për planin e punës së kryetarit të Komunës së Mitrovicës për vitin 2012

4.Vendim për Planin e punës së Auditorit të Brendshëm I Komunës së Mitrovicës.

5.Vendim për Planin vjetor fiskal 2012 të prokurimit.

6.Vendim për shtimin e buxhetit të planifikuar nga të hyrat vetanake të vitit 2011 në shumë prej 80.909.78 euro.

7. Vendim mbi ndryshimin e Vendimit të kuvendit të komunës nr.02/06-3646/10 dt. 31.01.2012 për shtimin e buxhetit të planifikuar nga të hyrat vetanake të vitit 2011, shpërndarja e këtij shtimi dhe bartja në buxhetin e vitit 2012.

Me këtë vendim bëhet ndryshimi i Vendimit të kuvendit të komunës nr.02/06-3646/10 dt. 31.01.2012 për shtimin e buxhetit të planifikuar nga të hyrat vetanake të vitit 2011, shpërndarja e këtij shtimi dhe bartja në buxhetin e vitit 2012.

8. Vendim mbi caktimin e Ditës së Dëshmoreve të UÇK-së.

Me këtë vendim bëhet caktimi i Ditës së Dëshmoreve të UÇK-së.

9. Vendim mbi kompensimin, ndërrimin e pronës së paluajtshme – sipërfaqes së tokës pronë private me sipërfaqe tjetër të tokës së pronës komunale.

Me këtë vendim bëhet kompensimi, ndërrimin e pronës së paluajtshme – sipërfaqes së tokës pronë private me sipërfaqe tjetër të tokës së pronës komunale.

10. Vendim mbi caktimin lokacionit me destinime për ndërtimin e objektit të shkollës fillore.

Me këtë vendim bëhet caktimi i lokacionit me destinime për ndërtimin e objektit të shkollës fillore.

11.Vendim mbi caktimin e lokacionit me destinime për ndërtimin e objektit të shkollës së mesme profesionale.

Me këtë vendim bëhet caktimi i e lokacionit me destinime për ndërtimin e objektit të shkollës së mesme profesionale.

12. Vendim mbi caktimin e lokacionit me destinime për ndërtimin e fermës për rritjen e pulave dhe Bio- vezët.

Me këtë vendim bëhet caktimi i lokacionit me destinime për ndërtimin e fermës për rritjen e pulave dhe Bio- vezët.

13. Vendim mbi planin e veprimit për përmasimin e shërbimeve.

Me këtë vendim bëhet plani i veprimit për përmasimin e shërbimeve.

14. Vendim mbi Raportin e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjës Komunale „Uniteti„

Me këtë vendim miratohet vendimi për Raportin e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjës Komunale „Uniteti„

Komuna e Vushtrris

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 9 vendime .

Janar-Qershor 2012

Vendimet

1.Vendim mbi raportit për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2011.

2.Vendim mbi raportit për punën e Komitetit për Komunitete për vitin 2011.

3.Vendim mbi raportit për punën e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2010/2011.

4.Vendim mbi raportit për punën e Komitetit Konsultativ për Ekonomi dhe Shërbime Publike për vitin 2010/2011.

5.Vendim për hartimin e planeve rregulluese urbane në Komunën e Vushtrrisë.

6.Vendim për emërimin e bordit këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese komunale

7.Vendim për qitje në diskutim publik të Draft-Rregullores për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë, (shqyrtimi i parë).

8.Vendim për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione

9.Vendim për raportin vjetor për punën e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Komuna e Skenderait

Kuvendi i Komunës së Skenderait gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 5 vendime .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për caktimin e linjeve, relacionit dhe rendit të udhëtimit në Transportin e Rregullt të Udhëtarëve, në Trafikun Urban dhe Periferik në komunën e Skenderajt.

Vendimet

1.Vendimi mbi miratimin e raportin janar-dhjetor 2011

2. Vendim për dhënien në diskutim publik përkufizimin e kufirit të zonës se veçantë te Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

3. Vendim për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha nr.01-110-1

4. Vendim për qitjen në diskutim publik të Projekt-Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimet tjera në territorin e komunës se Skenderajt

5. Vendim për blerjen e lop-topave për këshilltarët komunal

Komuna e Kamenicës

Kuvendi i Komunës së Kamenicës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 20 vendime dhe 1 rregullore. .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për organizimin e brendshëm të Administratës Komunale në Komunën e Kamenicës

Kjo Rregullore përcakton organizimin e brendshëm të administratës komunale të Komunës së Kamenicës (në tekstin e mëtejme duke iu referuar si: Rregullorja)

Vendimet

1.Vendim mbi ndarjen e mjeteve shtesë për bursa të studentëve në shumë prej 25.000€;

Me këtë Vendim ndahen mjete shtesë në lartësi prej 25.000€ për bursa të studentëve.

2.Vendim mbi ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 4.000€;

Me këtë Vendim i ndahen mjete financiare në shumë prej 4.000€ e delegacionit të Komunës së Kamenicës i cili prej datës 19-23 shkurt 2012 udhëton për vizitë në Komunën Mustafa Kemajl Pasha të Bursës.

3.Vendim për binjakëzimin e Komunës së Kamenicës me Komunën Mustafa Kemajl Pasha të Turqisë;

Me këtë Vendim, Komunës së Kamenicës i epet pëlqimi për binjakëzim me Komunën Mustafa Kemajl Pasha të Turqisë.

4.Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores komunale për ngarkesa, tarifa, taksa dhe gjoba komunale

Me këtë Vendim ndryshohet pjesërisht Rregullorja 01/17 dt.13.04.2011 për ngarkesa, tarifa, taksa dhe gjoba komunale.

5.Vendim për lejimin e ndërrimit të destinimit nga toka bujqësore-serën (bahqen) e qelqit në tokë ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës për banim, objekte afariste dhe objekte me interes të përgjithshëm

Me këtë Vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore-seren(bahqen) e qelqit në tokë ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës për banim, objekte afariste dhe objekte me interes.

6.Vendim për bartjen e të hyrave vetanake 2010, 2011 në vitin 2012

Me këtë Vendim, organizata buxhetore e Komunës së Kamenicës, për vitin 2011 ka realizuar të hyra vetanake në shumë prej 796.775.40 €. Andaj në bazë të vendimit të Kuvendit shuma prej 500.339.86€ është e shpërndarë sipas programeve.

7.Vendim mbi rritjen e të hyrave vetanake 2011

Me këtë Vendim, organizata buxhetore e Komunës së Kamenicës për vitin 2011 ka realizuar të hyra vetanake në shumë prej 796.775.40€ nga të cilat shuma prej 648.703.00€ janë flokuar dhe kanë mbet për tu flokuar shuma prej 148.072.40€. Andaj në bazë të vendimit të Kuvendit shuma prej 148.072.40€ është shpërndarë sipas programeve.

8.Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave lidhur me dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të Komunës

Me këtë Vendim, formohet komisioni për vlerësimin e ofertave lidhur me dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të Komunës. (Vendi i quajtur "POPOCA")

9. Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave lidhur me dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të Komunës

Me këtë Vendim, formohet komisioni për vlerësimin e ofertave lidhur me dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të Komunës.(Vendi i quajtur "OGRAXHE")

10.Vendim për ridestinimin të mjeteve;

Me këtë vendim, bëhet ri-alokimi i projektit kapital brenda programit, Zyra e Kryetarit (160), nën-programi Zyra e Kryetarit *16029), fondi burimor (10).

11.Vendim për ndarjen e mjeteve për bashkëfinancim në ndërtimin e xhamisë në lagjen e epërme në Koretin;

Me këtë Vendim, ndahen mjete financiare në shumë prej 15.000.00 € për bashkëfinancim për ndërtimin e xhamisë në lagjen e epërme në Koretin. Mjetet ndahen nga kodi 8627.

12.Vendim mbi lejimin e dislokimit të lapidarit të dëshmorit të kombit Ramadan Kastrati

Me këtë Vendim, lejohet dislokimi i Lapidarit të Dëshmorit të Kombit Ramadan Kastrati.

13.Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Administratës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë

Me këtë Vendim, caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të administratës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë, caktohet në pjesën e ngastrës kadastrale P-71107041-01343-0 në vendin e quajtur "Plepat" në sipërfaqe prej 0.03.00 ha (300 m²), e cila në Zyrën Kadastrale Komunale në Kamenicë është e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71107041-00430, si P.SH. Kuvendi Komunal, Kamenicës, për Z.K.Kamenicë.

14.Vendim mbi njohjen e të drejtës së shfrytëzimit të patundshmërisë komunale për qasje në rrugë dhe bodrum nga shtëpia e banimit

Me këtë Vendim, i njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm, të patundshmërisë komunale për qasje në rrugë dhe bodrum nga shtëpia e Naziktere Spahiut në pjesën e ngastrës kadastrale nr.0-711-7-41-01605-6-1-0-1-0, në gjerësi prej 2 m nga hyrja e shtëpisë dhe gjatësi prej 8m.

15.Vendim mbi formimin e grupit punues për menaxhimin e aseteve- pronës së paluajtshme të Komunës

Me këtë Vendim, formohet grupi punues për menaxhimin

16.Rishqyrtimi i buxhetit komunal për vitin 2012;

Me këtë Vendim, bëhet rishqyrtimi i buxhetit komunal.

17.Vendim për mbështetje financiare të Astrit Kryeziut dhe Musa Hajdarit atletë të KA "ROGANA" nga Rogana;

Me këtë Vendim, mbështeten financiarisht Astrit Kryeziu dhe Musa Hajdari atletë të KA "Rogana" nga Rogana për stërvitje dhe pjesëmarrje në garat ndërkombëtare.

18.Vendim për lejimin e shfrytëzimi të autoambulancës për nevojat e qytetarëve jashtë territorit të Komunës së Kamenicës për raste jourgjente;

Me këtë Vendim, qytetarëve të Komunës së Kamenicës për raste jourgjente iu lejohet shfrytëzimi i autoambulancës jashtë territorit të Komunës së Kamenicës.

19.Vendim mbi ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 4.000€

Me këtë Vendim, i ndahen mjete financiare në shumë prej 4.000 € Kuvendit të Komunës dhe administratës komunale për një vizitë pune në Shqipëri.

20.Vendim për hapjen e debatit publik me qytetarët lidhur me hartimin e planit zhvillimor komunal dhe planit zhvillimor urban;

Me këtë Vendim, hapet debati publik me qytetarët të cilët do të njoftohen me punën e komisionit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban.

Komuna e Novo Bërdë

Kuvendi i Komunës së Novo Bërdës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 34 vendime dhe 5 rregullore. .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për ndarjen e bursave në Komunën e Novobërdës

Me këtë Rregullore, rregullohet ndarja e bursave në Komunën e Novobërdës.

2.Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Novobërdës;

Kjo Rregullore, ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

3.Rregullore për ushtrimin e veprimtarisë së transportit auto-taxi të udhëtarëve në Komunën e Novobërdës;

Me këtë Rregullore parashihet ushtrimi i veprimtarisë së transportit auto-taxi të udhëtarëve në Komunën e Novobërdës.

4.Rregullore mbi mënyrën dhe kushtet e eksploatimit të rërës dhe gurit natyror në territorin e Komunës së Novobërdës;

5.Rregullore për korrje - shirje;

Vendimet

1.Vendim mbi lirimin nga tarifat dhe ngarkesat komunale në Komunën e Novobërdës;

Ky Vendim ka për qëllim nxitjen e zhvillimit lokal ekonomik, bizneset prodhuese në Komunën e Novobërdës, lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale për 5 (pesë) vitet e ardhshme duke filluar prej 01.01.2012.

2.Vendim mbi aprovimin e Raportit të Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;

Me këtë Vendim, aprovohet raporti i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport të Komunës së Novobërdës për mbarimin e gjysmë vjetorit të parë dhe fillimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2011/2012.

3.Vendim mbi aprovimin e raportit financiar

Me këtë Vendim aprovohet raporti financiar i Komunës së Novobërdës për tremujorin e katërt të vitit fiskal 2011 për të hyrat vetanake dhe të dalurat.

4.Vendim mbi aprovimin e Rregullores për ndarjen e bursave në Komunën e Novobërdës

Me këtë Vendim aprovohet Rregullorja për ndarjen e bursave në Komunën e Novobërdës

5.Vendim mbi bartjen nga të hyrat vetanake të vitit 2011 në vitin 2012

Me këtë Vendim barten mjetet financiare nga të hyrat vetanake në shumë prej 65.770.34€ të vitit 2011 në vitin 2012.

6.Vendim mbi bartjen nga të hyrat vetanake të vitit 2011

Me këtë Vendim rriten mjetet financiare nga të hyrat vetanake në shumë prej 38.894.32€ të vitit 2011.

7. Vendim për themelimin e institucionit publik parashkollor, çerdhja e fëmijëve “Kolibri” në fshatin Koretishtë të Komunës së Novobërdës;

Me këtë vendim, themelohet institucioni publik parashkollor, çerdhja e fëmijëve “Kolibri” në fshatin Koretishtë të Komunës së Novobërdës.

8. Vendim për themelimin e shkollës fillore dhe të mesme të muzikës “Stevan Hristiq” në fshatin Stanishor të Komunës së Novobërdës;

Me këtë vendim, themelohet shkolla fillore dhe e mesme e muzikës “Stevan Hristiq” në fshatin Stanishor të Komunës së Novobërdës.

9.Vendim për dërgimin në diskutim publik të draft Rregullores për korrje-shirje në Komunën e Novobërdës.

10.Vendim për dhënien e ndihmës për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes së Rexhep Zeqirit nga Llabjani.

Me këtë Vendim, aprovohet dhënia e ndihmës për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes së Rexhep Zeqirit nga Llabjani.

11.Vendim për caktimin e lartësisë së bursave dhe formimin e komisionit për ndarjen e bursave

Me këtë Vendim, aprovohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për caktimin e lartësisë së bursave dhe formimin e komisionit për ndarjen e bursave.

12.Vendim për dhënien e ndihmës për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes së Tahir Zeqirit nga Llabjani.

Me këtë Vendim, aprovohet dhënia e ndihmës për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes së Tahir Zeqirit nga Llabjani.

13.Vendim për ndërtimin e trafo elektrike në Makresh të Epërm

Me këtë Vendim, aprovohet ndërtimi i trafo elektrike në Makresh të Epërm.

14.Vendim për dhënien e ndihmës Shoqatës ndërkomunale të Verbërve dhe me t pamë të dobësuar në Gjilan në vlerë prej 300€.

Me këtë Vendim, aprovohet dhënia e ndihmës Shoqatës ndërkomunale të Verbërve dhe me t pamë të dobësuar në Gjilan në vlerë prej 300€.

15.Vendim për miratimin e Rregullores për marrëveshjen me fshatra, lagje dhe vendbanime në Komunën e Novobërdës.

Me këtë Vendim, aprovohet Rregullorja për marrëveshjen me fshatra, lagje dhe vendbanime në Komunën e Novobërdës.

16.Vendim për dërgimin në diskutim publik të draft Rregullores për Auto-Taxi.

Me këtë Vendim, dërgohet në diskutim publik draft Rregullorja për Auto-Taxi.

17.Vendim për aprovimin e raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2011

Me këtë Vendim, aprovohet raporti financiar për periudhën janar – dhjetor 2011.

18.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin në spitalin e Kardiologjisë në Gjilan;

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e z. Vehbi Zeqirit për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200 € për shërimin e vetë në spitalin e Kardiologjisë në Gjilan.

19.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin e fëmiut dy vjeçar;

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e z. Svetimir Maksimoviq për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200 € për shërimin e fëmiut dy vjeçar.

20.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 500 €;

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e pensionistëve të Komunës së Novobërdës për dhënien e ndihmës në vlerë prej 500€.

21.Vendim për projektet kapitale;

Në këtë vendim, hynë këto projekte:

1.Riparimi i rrugëve lokale në Pasjak në vlerë prej 8.500,00€;

2.Pagesa për përgatitjen e projektit ndërtimi i shtegut për ecje në Kala në vlerë prej 3.200,00€;

3.Renovimi i aneksit të Komunës së Novobërdës në vlerë prej 100.000,00 € nga MAPL dhe 35.000,00 \$ grand stimulus nga USAID-i.

22.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 300€ për operimin e bashkëshortes së tij Sabrije Ramadanit;

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e z.Muhamet Ramadanit për dhënien e ndihmës në vlerë prej 300€ për operimin e bashkëshortes së tij Sabrije Ramadanit.

23.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin e bashkëshortes në spital;

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e z. Hetem Vllasaliut për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin e bashkëshortes së tij në spital.

24.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin e fëmiut 5 (pesë) muajsh në spital;

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e z. Dejan Stojanoviq për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin e fëmiut 5 (pesë) muajsh në spital.

25.Vendim për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin në spital.

Me këtë vendim, aprovohet pjesërisht kërkesa e z. Artan Zymerit për dhënien e ndihmës në vlerë prej 200€ për shërimin në spital.

26.Vendim mbi aprovimin e raportit financiar

Me këtë vendim, aprovohet raporti financiar i Komunës së Novobërdës për tre mujorin e parë të vitit fiskal 2012.

27.Vendim për formimin e komisionit;

Me këtë Vendim, formohet komisioni për përgatitjen e përzgjedhjes së këshillave të fshatrave;

28.Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës lejon transferin e mjeteve për mbulimin e minusit të pagave.

29.Vendim për miratimin e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së transportit auto-taxi të udhëtarëve në Komunën e Novobërdës;

Me këtë Vendim, aprovohet Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit auto-taxi të udhëtarëve në Komunën e Novobërdës.

30.Vendim për diskutim publik të draft Rregullores mbi mënyrën dhe kushtet e eksplotimit të rërës dhe gurit natyror në territorin e Komunës së Novobërdës;

Me këtë vendim, kalohet për diskutim publik draft Rregullorja mbi mënyrën dhe kushtet e eksplotimit të rërës dhe gurit natyror në territorin e Komunës së Novobërdës.

31.Vendim për shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit Komunal;

32. Vendim për diskutim publik të Rregullores për ndarjen e subvencioneve;
33. Vendim për participim të projekteve nga kodi i arsimit;
34. Vendim për diskutim publik për projektin “Plani Strategjik për Zhvillimin Kulturor në Komunën e Novobërdës plani i hartuar në bashkëpunim me teatrin “ODA” dhe ekspertë ndërkombëtar;

Komuna e Mamushës

Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 8 vendime dhe 1 rregullore. .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për orarin e punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Mamushës

Vendimet

1.Vendim për miratimin e rregullores për orarin e punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Mamushës.

Më këtë vendim, miratohet rregullorja për orarin e punës të subjekteve afariste në komunën e Mamushës.

2. Vendim për miratimin e raportit të punës se Kryetarit të Komunës së Mamushës.

Më këtë vendim, miratohet raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2011.

3.Vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake 2010 dhe 2011 në vitin 2012.

Më këtë vendim, bëhet bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2010 dhe 2011 në vitin 2012.

4.Vendim për miratimin e Emblemës së Komunës së Mamushës.

Më këtë vendim miratohet emblema e Komunës së Mamushës

5.Vendim për binjakëzimin me Komunën e Elazig të Republikës së Turqisë;

Me këtë vendim, Kuvendi ka miratuar propozimin e Kryetarit për binjakëzimin e komunës së Mamushës me komunën e Elazig të Republikës së Turqisë;

6.Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012;

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar rishikimin e buxhetit të komunës sipas propozimeve të bëra nga ekzekutivi i komunës.

7.Vendim për themelimin e komisionit intervistues për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave;

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar rishikimin e buxhetit të komunës sipas propozimeve të bëra nga ekzekutivi i komunës.

8.Vendim për binjakëzimin e komunës së Mamushës me komunën Boztepe të Republikës së Turqisë;

Me këtë vendim, Kuvendi ka miratuar propozimin e Kryetarit për binjakëzimin e komunës së Mamushës me komunën Boztepe të Republikës së Turqisë;

Komuna e Prizrenit

Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 29 vendime dhe 2 rregullore. .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për transparencë.

2.Rregullore për përdorimin e gjuhëve

Kjo Rregullore do të sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në punën e administratës komunale, në institucionet arsimore dhe shëndetësore që themelohen, apo qeverisen nga Komuna dhe në ndërmarrjet publike lokale të themeluara nga Komuna.

Vendimet

1.Vendim për Planin të Punës së Kuvendit për vitin 2012;

2. Vendim për dhënien me qira të pronës komunale ECDP-së;

3. Vendim për kushtëzimin e pagesës së mbeturinave të çdo lloj biznesi dhe ekonomive familjare me rastin e regjistrimit të automjeteve e veprimeve tjera nga ana e qytetareve të Prizrenit.

4. Vendim për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara nga të hyrat vetanake nga viti 2010 dhe 2011 në vitin 2012.

5. Vendim për miratimin e planit rregullues urban për zonën "Boka".

6. Vendim për miratimin e planit rregullës urban për kuadratet E 5.6, E 5.9 dhe një pjesë të kuadratit F 5.2.

7. Vendim për miratimin e planit rregullues, zonës së veçantë për industri të lehtë (të mesme dhe të vogël) - "Parku i Biznesit".

8. Vendim për lejimin e organizmit të shqyrtimit publik të planit rregullues urban "Industri- zonë e lirë dhe terminali" të qytetit të Prizrenit.

9. Vendim për lejimin e organizmit të shqyrtimit publik të planit rregullues urban "Kuadrantet F 5.5, F 5.6 dhe F 5.7" të qytetit të Prizrenit.

10. Vendim për lejimin e organizmit të shqyrtimit publik të planit rregullues urban "Tregti dhe industri e vogël" të qytetit të Prizrenit.

11. Vendim për lejimin e organizimit të shqyrtimit publik të planit rregullues urban të një pjese të lagjes "Lakuriq Verior" të qytetit të Prizrenit.

12. Vendim për lejimin e hartimit të planit rregullues urban për gjatë rrugës Prizren-Landovicë, përkatësisht të anës së majtë të rrugës dhe të një pjese të anës së djathtë të rrugës së qytetit të Prizrenit.

13. Vendim për themelimin dhe emërimin e komisionit për përcjelljen e implementimit të rregullores për përdorimin e gjuhëve zyrtare në territorin e komunës së Prizrenit

Me këtë Vendim themelohet Komisioni për përcjelljen e zbatimit të Rregullores për përdorimin e gjuhëve zyrtare në territorin e Komunës së Prizrenit. Komisioni do të përbëhet prej 6 anëtarëve, që do të emërohen 3 anëtarë nga ana e Komitetit për Politik dhe Financa dhe 3 anëtarë që do të emërohen nga ana e Komitetit për Komunitete, nga rradhët e të cilëve në mbledhjen e parë duhet të zgjedhin kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Komisionit.

14. Vendim për furnizim me kartela mbushëse për telefona celular për anëtarët e kuvendit

Aprovohet propozimi i anëtarëve të kuvendit për lejimin e furnizimit me kartela mbushëse për telefona celular, ashtu që për këtë qëllim secili anëtarë i Kuvendit duke filluar që nga muaji mars 2012, dhe për çdo muaj në vijim, do të furnizohet me 20 euro mbushje, gjersa Shefat e grupeve parlamentare me 30 euro mbushje për telefona mobile.

15. Vendim për lejimin e huamarrjes (kredisë) me qëllim të realizimit të projektit të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza të qytetit të Prizrenit

Miratohet propozimi i Kryetarit të komunës sipas propozimit: Të Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë së Administratës-sektori i Pronës dhe Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, ashtu që Lejohet huamarrja (kredia) nga ana e Komunës, me qëllim të sigurimit të mjeteve të duhura financiare për kompensimin e pronarëve për pronat që do të shpronësohen me qëllim të realizimit të Projektit të ndërtimit të Impiantit të ujërave të zeza të qytetit të Prizrenit.

16. Vendim për themelimin dhe emërimin e komisionit për manifestimin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

Me këtë Vendim themelohet Komisioni për manifestimin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Komisioni do të përbëhet prej shefave të grupeve parlamentare që janë të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, nga rradhët e të cilëve në mbledhjen e parë duhet të zgjedhin kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Komisionit.

17. Vendim për vazhdimin e procedurave për binjakëzimin e komunës së prizrenit me qytetin e Kijovës - Republika e Çekisë

Me këtë Vendim miratohet propozimi për vazhdimin e procedurave përkatëse me qëllim të binjakëzimit të Komunës së Prizrenit me qytetin e Kijovës, nga Republika e Çekisë.

18. Vendim për kushtëzimin e lëshimit të vërtetimit të tatimit në pronë për regjistrimin e automjeteve

APROVOHET propozimi i Kryetarit të Komunës sipas kërkesës të KRM "Ekoregjionit"-njësia në Prizren, ashtu që me këtë Vendim kushtëzohet lëshimi i vërtetimit të tatimit mbi pronë, me qëllim të regjistrimit të automjeteve.

Lëshimi i vërtetimit për tatimin në pronë do të bëhet pasi që parashtruesi i kërkesës për lëshimin e vërtetimit të dëshmoj me vërtetim të lëshuar nga ana e "Ekoregjionit" njësia në Prizren dhe kompanitë tjerë që ofrojnë shërbime nga kjo lëmi në territorin e komunës së Prizrenit, se ka të shlyera borxhet për bartjen e mbeturinave nga ana e kësaj kompanie.

19.Vendim për vazhdimin e procedurave për nënshkrimin e memorandumit për bashkëpunimin e Komunës së Prizrenit me Komunën Çair të qytetit të Shkupit - Republika e Maqedonisë;

Me këtë Vendim, miratohet propozimi për vazhdimin e procedurave përkatëse me qëllim të përgatitjeve për Memorandumin e Bashkëpunimit të Komunës së Prizrenit me Komunën Çair, nga Republika e Maqedonisë.

20.Vendim për ndryshimin e vendimit të kuvendit të komunës për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2010 dhe 2011 në vitin 2012, nr.01/011-2338, të datës 29 shkurt 2012;

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi i vendimit të Kuvendit të Komunës për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2010 dhe 2011, në vitin 2012, nr.01/011-2338, të datës 29 shkurt 2012, ashtu që në nenin 1 të vendimit të sipërpërmendur, në vend të shumës “prej 1.137.901,69” euro do të qendrojë shuma prej 1.068.999,90 euro.

21.Vendim për miratimin e planit të veprimit për integrimin e komuniteteve: rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit;

Me këtë Vendim miratohet Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve: Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit.

22.Vendim për miratimin e planit të veprimit për barazi gjinore në Komunën e Prizrenit;

Me këtë Vendim miratohet, Plani i Veprimit për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit.

23.Vendim për lejimin e shqyrtimit publik të planit rregullues urban përgjatë rrugës prizren-landovicë, përkatësisht anës së majtë të rrugës dhe një pjesë të anës së djathtë të rrugës në qytetin e Prizrenit;

Me këtë Vendim lejohet vënia në shqyrtim publik e Planit Rregullues Urban (PRRU-së) për lokacionin përgjatë rrugës Prizren -Landovicë, përkatësisht anës së majtë të rrugës dhe një pjesë të anës së djathtë të rrugës në qytetin e Prizrenit, i cili është hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit, miratuar nga Asambleja Komunale e KK Prizren më dt. 16. shtator 2004

24.Vendim për lejimin e shqyrtimit publik të planit rregullues urban të kuadratit f. 6.2 të qytetit të Prizrenit;

Me këtë Vendim lejohet vënia në shqyrtim publik e Planit Rregullues Urban (PRRU-së) për lokacionin e Kuadratit F. 6.2 të qytetit të Prizrenit , i cili është hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit, miratuar nga Asambleja Komunale KK Prizren më dt. 16. shtator 2004.

25.Vendim mbi shpalljen e interesit publik

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës shpallë interesin publik për objektin e ish-Bankosit, i cili gjendet në ngastrën kadastrale me nr. 2368/1 ZK Prizren, e cila evidentohet sipas listës poseduese me nr. 8414, si pronë shoqërore KK Prizren, e që menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

26.Vendim për ridestinimin e mjeteve në buxhetin e Komunës për vitin 2012;

Me këtë vendim, është bërë ridestini i mjeteve në buxhetin e Komunës për vitin 2012.

27.Vendim për vërtetimin e interesit publik sipas kërkesës së banorëve të Zhupës;

28.Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale banorëve të fshatit Petrovë, Bashkësisë Islame dega në Prizren;

29.Vendim për harmonizimin e Rregullores për transparencë nr.010112570 e datës 29.02.2012 sipas sugjerimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;

Komuna e Kaçanikut

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 11 vendime dhe 1 rregullore. .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për ndryshim dhe plotësimin e Rregullores 01Nr.05-8253/10- Për përcaktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut.

Kuvendi ka bere plotësimin dhe ndryshimin e rregullores 01Nr.05-8253/10- Për përcaktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut ku sipas propozimit ndryshohet paragrafi 4.2.2 i nenit 4 të Rregullores dhe zëvendësohet me propozimin që orari i punës së shitoreve dhe veprimtarive tregtare jo ushqimore fillon në ora 8:00 – 22:00 për periudhën verore dhe nga 8:00 – 20:00 për sezonin dimëror.

Vendimet

1. Vendim për aprovimin e planit të mbledhjeve të kuvendit, për vitin 2011;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar planin e punës së kuvendit për vitin 2012 ku ka paraparë numrin e mbledhjeve si dhe çështjet që do të shqyrtohen gjate kësaj periudhe një vjeçare.

2. Vendim për miratimin Raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2011;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar Raportin e punës së Ekzekutivit të komunës së Kaçanikut për periudhën e vitit 2011.

3. Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimeve të shënjëzimit rrugor;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar Planin e Veprimit për përmirësimin e shërbimit të shënjëzimit rrugor të propozuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës ky planë hap rrugë për investime në përmirësimin e shënjëzimit horizontal dhe vertikal në komunën e Kaçanikut.

4. Vendimi për bartjen e bilanceve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2010, 2011 në vitin 2012;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2010 dhe 2011 në buxhetin e vitit 2012.

5. Vendim për miratimin e Raportit Vjetor Financiar, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar Raportin Vjetor Financiar, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011, në të cilin janë të përfshira të gjitha të dhënat buxhetore gjatë vitit 2011.

6. Vendim për miratimin e Raportit Vjetor Financiar, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar Raportin Vjetor Financiar, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011, në të cilin janë të përfshira të gjitha të dhënat buxhetore gjatë vitit 2011.

7. Vendimi për Hartimin e Planeve rregulluese për Zonat Turistike,

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për hartimin e planeve rregulluese për zonat turistike në komunën e Kaçanikut respektivisht në SHPATIJAT e malit Sharr. E gjithë kjo më qëllim të krijimit të kushteve bazë për zhvillimin e turizmit në komunën e Kaçanikut për zhvillimin e turizmit si veprimtari e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës.

8. Vendimi për lirimin e bizneseve komunale nga taksat-ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre afariste.

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për lirimin e bizneseve komunale nga taksat-ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre afariste.

9. Vendimi për riemërimin e pronës së paluajtshme komunale.

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për riemërimin e pronësisë së paluajtshme të pronës komunale duke përfshi institucionet arsimore, shëndetësore, ish

Bashkësitë Vetëqeverisëse të Interesit, të cilat deri më tani janë evidentuar si pasuri shoqërore e cila do të emërohet pronë komunale.

10. Vendimi për ndërrimin e pasurisë së paluajtshme të komunës ;

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar edhe Propozim vendimin për ndërrimin e pasurisë së paluajtshme me të cilin bëhet ndërrimi i pasurisë së paluajtshme të Komunës së Komunës dhe z. Tahire Memishi nga fshati Elezaj. Ndërrimi i pasurisë së paluajtshme është bërë me qëllim të ndërtimit të ambulancës shëndetësore në lokacion të përshtatshëm për fshatrat Elezaj, Duraj, Gabrricë e më gjerë.

11. Vendim për Rishikimin e Buxhetit të komunës për vitin 2012;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar rishikimin e buxhetit për vitin 2012, më ndryshimet të cilat janë bërë nga ekzekutivi i komunës .

Komuna e Prishtinës

Kuvendi i Komunës së Prishtinës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 19 vendime dhe 1 rregullore. .

Janar-Qershor

Rregulloret

1. Rregullorja për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve.

Me këtë rregullore rregullohen kushtet dhe caktohen kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve në territorin e komunës së Prishtinës.

Vendimet

1. Vendim për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Me këtë vendim i vazhdohet i shfrytëzimit të pronës komunale subjekteve të caktuara

2. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

3. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente.

Me këto vendime miratohen Statutet e këtyre qendrave, pas harmonizimit me ligjet në fuqi.

4. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të kombinuar.

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e tregut të kombinuar, në zonën kadastrale Bërrnicë e Epërme.

5. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Xhamisë së Prishtinës.

Ky vendim parasheh caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Xhamisë së Prishtinës, lokacioni për ndërtimin e objektit - xhamisë, shtrihet në ngastrat kadastrale: nr. 7437/1 dhe 7571, Certifikata e pronësisë. nr. 4137, Zona Kadastrale Prishtinë, zonë urbane, vendi i quajtur "Blloku III i Ndërtesave", në sipërfaqe prej 8100 m², P.SH. Kuvendi Komunal i Prishtinës.

6. Vendim për ndryshimin e rregullores për transparencë.

Me këtë vendim ndryshohet rregullorja për transparencë në komunë.

7. Vendim për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012.

Ky vendim parasheh bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012, në kategori të caktuara.

8. Vendim për miratimin e raporteve të ndërmarrjeve publike: "Termokos" "Hortikultura" dhe "Pastrimi"

Ky vendim parasheh miratimin e raporteve të këtyre ndërmarrjeve të paraqitur nga komisioni i aksionarëve

9. Vendim për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme.

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme, 01 nr. 110-1936, të dt. 28.7.2010.

10 . Vendim për inkorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese

Ky vendim parasheh inkorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese

11. Vendim për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore - afariste

Me këtë vendim caktohen kriteret për ndërrimin e destinimit të hapësirave banesore afariste

12. Vendim për llogaritjen dhe kompensimin për vlerësimin, mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolodimin e investimeve komunale dhe investimeve të tjera në Komunën e Prishtinës.

Ky vendim parasheh llogaritjen e kompensimit për vlerësim mbikëqyrje, pranimin teknik të investimeve në komunë.

13. Vendim për garanci të kthimit të kredisë

Ky vendim parasheh garancionin për kthimin e borxhit Ministrisë së Financave, nga komuna dhe "Termokosi"

14. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet kjo rregullore pas ndryshimeve që janë bërë në Udhëzimit administrativ nr. 11/2011, te dt. 30.12.2011.

15. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve në lagjen "Kodra e Trimave 1"

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve pas.

16. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prenk Jakova" në Prishtinë

Ky vendim parasheh caktimin e lokacionit për ndërtimin e kësaj shkolle.

17. Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012;

Me këtë vendim, parashihet rishikimi i buxhetit për vitin 2012.

18. Vendim për miratimin e Planit rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë;

19. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimores së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra;

Komuna e Shtërpçës

Kuvendi i Komunës së Shtërpçes gjatë periudhës janar - qershor 2012 ka miratuar 15 vendime dhe 4 rregullore. .

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore për te drejtat dhe detyrat dhe përgjegjësit e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Shtërpcës

Me këtë rregullore përcaktohen të drejtat detyrat dhe përgjegjësit e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Shtërpcës, shkeljet e detyrave dhe rregullave të nxënësve masat disiplinore, sjelljet e nxënësve etj.

2.Rregullore për taksat, tarifat dhe ndëshkimet komunale

Me këtë rregullore caktohet lartësia e tarifave ngarkesave dhe gjobave komunale për shërbimet dhe veprimtaritë komunale ne territorin e komunës së Shtërpcës,.

3.Rregullore mbi orarin e punës te objekteve komerciale;

Më këtë rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi I orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera: hoteleri, zejtari dhe shërbime tjera të organizimit në territorin e komunës së Shtërpcës.

4.Rregullore për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transferove

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve financiare të buxhetit të Komunës së Shtërpcës nga kategoria për Subvencione dhe Transfere për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike.

Vendimet**1. Vendim mbi përcaktimin e lokacionit për qendrën për punë sociale.**

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar ndarjen e Lokacioni për ndërtimin e objektit përfshin ngastrën kadastrore nr 2211 zona kadastrale Shterpce fleta poseduese nr. 467, në sipërfaqe prej 3 ari vendi i quajtur "Taraia", me kulturë kullosë kl. 4, pronë shoqërore, në emër të " Të komunës Shtërpcë".

2. Vendim vendimi për themelimin e spitalit ne Shtërpcë;

Me këtë vendim kuvendi themelon spitalin e komunës së Shtërpcës i cili do të ofroj të gjitha shërbimet shëndetësore të cilat janë te parapara më ligjin për shëndetësi si dhe aktet nënligjore të lëshuara nga Ministria e shëndetësisë.

3.Vendim për miratimin e planit vjetor të punës së kuvendit komunal për vitin 2012

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2012 ku në baze të këtij plani ka miratuar orarin e mbajtjes së mbledhjeve si dhe agjendën për këto mbledhje gjate kësaj periudhe.

4. Vendim qe propozim rregullorja mbi orarin e punës së objekteve komerciale të kaloj në diskutim publik

Me këtë vendim kuvendi ka kaluar ne diskutim publik rregulloren për orarin e punës së objekteve komerciale ne mënyrë qe pas diskutimit publik te kthehet ne kuvend për miratim.

4. Vendim që propozim rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale (ndryshimi dhe plotësimi) të kaloj në diskutim publik

Me këtë vendim kuvendi ka kaluar ne diskutim publik rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale (ndryshimi dhe plotësimi) ne mënyrë qe pas diskutimit publik te kthehet ne kuvend për miratim.

5. Vendim që propozim rregullorja për përgjegjësit e nxënësve të shkollës së mesme të lartë gjimnazi “Kongresi i Manastirit të kaloj në diskutim publik;

Me këtë vendim kuvendi ka kaluar ne diskutim publik rregulloren për përgjegjësit e nxënësve të shkollës së mesme të lartë gjimnazi “Kongresi i Manastirit ne mënyrë qe pas diskutimit publik te kthehet ne kuvend për miratim.

6. Vendim mbi rritjen e planit për te hyrat vetanake në vitin 2011

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për rritjen e shumës së planifikuar të buxhetit me burimin Te hyrat vetanake të komunës së Shtërpcës për vitin fiskal 2011, nga 189.805,25 euro në shumën e realizuar vjetore 237.055.07 euro ku vlera totale të rritur është 47.249.25 euro.

7. Vendim mbi bartjen e te hyrave vetanake në vitin 2012

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar vendimin për bartje të shumës së buxhetit me të hyrat vetanake të komunës së Shtërpcës nga viti fiskal 2011 në vitin fiskal 2012 e shumës së rritur të buxhetit prej 47.249.25 dhe shumës së pashpenzuar të buxhetit prej 4.080,95 euro që në total është 51.33.,20 euro.

8. Vendim për aprovimin e kërkesës së këshillit Gjyguesore –gjkata komunale në Ferizaj dega në Shterpce për lirim nga taksa për marrjen e lejes për ndërtimin e objektit të gjykatës në Shtërpcë;

Më këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën e këshillit gjygjësor komunal në Ferizaj dega në Shtërpcë për lirimin nga taksa komunale për ndërtimin e objektit të Gjykatës në komunën e Shtërpcës.

9. Vendimin për aprovimin e kërkesës se Ministrisë se Mjedisit dhe planifikimit hapësinore për leje ndërtimore për 6 objektet individuale të 6 familjeve të lagjes Smajlaj të fshatit Brod të Komunës së Shtërpcës;

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit hapësinor për leje ndërtimore për 6 objekte individuale të 6 familjeve të lagjes Smajlaj të fshatit Brod të komunës së Shtërpcës.

10. Vendim për formimin e komisionit për hartimin e statutit të spitalit të Shtërpcës;

Me këtë vendim kuvendi ka marrë vendim për formimin e komisionit për hartimin e propozim statutit të Spitalit të Shtërpcës, komisioni i cili do ta hartoj këtë propozim – statut, do të këtë përbërje prej 5 anëtarëve dhe ka këtë përbërje 1, Dr. Dejan Mergjinac, Dr. Menderes Hyseni, Sonja Durlovic, Havzi Ahmeti dhe Zorica Stanojevic

11.Vendim për vënie ne diskutim publik të propozim rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve në komunën e Shtërpcës

Me këtë vendim miratohet propozim rregullorja për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve në komunën e Shtërpcës dhe si propozim të vihet në diskutim publik.

12.Vendim për ndryshimin e vendimit nr.01-16-581 të datës 01.03.2012. për bartjen e buxhetit nga THVK-të nga viti 2011 në vitin 2012 në programe buxhetore dhe kategori ekonomike të shpenzimeve

Me këtë vendim miratohet ndryshimi i Vendimit nr.01-16-581 të datës 01.03.2012. për bartjen e buxhetit nga THVK-të e Komunës së Shtërpcës nga viti fiskal 2011 në vitin fiskal 2012 e shumës së rritur të buxhetit prej 47.249,25€ dhe shumës së pashpenzuar të buxhetit prej 4.080,95€ që në total është 51.330,20€.

13.Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtërpcës nr.01/459 të datës 08.06.2005 mbi ndalimin e përkohshëm të shitblerjes së paluajtshmërisë

Anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtërpcës nr.459 të datës 08.06.2005 mbi ndalimin e përkohshëm të shitblerjes së paluajtshmërisë.

14.Vendim për vënien në diskutim publik të propozim Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Shtërpcës;

Me këtë Vendim, miratohet propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Shtërpcës, dhe si propozim vihet në diskutim publik.

15.Vendim për miratimin e projekteve të financuara nga shpërblimet e fituara nga USAID-DEMI

Me këtë vendim parashihet realizimi i projekteve të financuar nga shpërblimi i fituar nga USAID-DEMI.

Komuna e Fush Kosovës

Kuvendi i Komunës së Fush Kosovës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 16 vendime .

Janar-Qershor 2012

Vendimet

1.Vendim për buxhetin e shpenzuar të Komunës së Fushë-Kosovë për vitin 2011.

Ky vendim parasheh buxhetin e shpenzuar në kategoritë e caktuara si : Administratë, arsim,shëndetësi dhe në zyrën për komunitete.

2.Vendim për aprovimin e planit zhvillimor urban të qytetit të Fushë Kosovë

Me kë plan ndryshohet dhe plotësohet plani zhvillimor urban në këtë komunë.

3.Vendim për aprovimin e planit lokal të veprimi për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruar rekreative për qytetarët e komunës së Fushë-Kosovë 2012-2013.

Ky plan parasheh përmirësimin e shërbimeve për mbrojtjen e mjedisit, krijimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbëruara.

4.Vendim për miratimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë- Kosovës 2012-2015.

Ky vendim parasheh aprovimin këtij plani i cili rregullon eliminimin e mbeturinave të egra, riciklimin e mbeturinave, krijimin e ekodepoje, themelimin e ndërmarrje për menaxhimin e tyre në të ardhmen.

5.Vendim për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me qira të 2 objekteve për Çerdhe të Fëmijëve, pronë e komunës.

Me këtë vendim jepet në shfrytëzim objektet pronë e komunës çerdheve të fëmijëve në fshatin Bardh i Madhë dhe Miradie e Poshtme

6. Vendim për ndryshimin e Statutit të Komunës, Nr. 56, të datës 29.04.2010.

Ky vendim parasheh ndryshim dhe plotësimin e Statutit të Komunës dhe i njëjti të kalohet në diskutim publik

7. Vendim shqyrtimin e Projekt-Rregullores për Shërbime Publike Komunale.

Ky vendim parasheh mënyrën e diskutimit publik të kësaj rregullore

8.Vendim për miratimin e Projekt-dokumentit për “Politikat rinore”

Ky vendim parasheh miratimin e këtij dokumenti që ka të bëjë me avancimin e rinis në këtë komunë.

9.Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për arsimin joformal

Me këtë vendim ndahen mjetet për arsimin joformal

10.Vendim për rishikimin e buxhetit të komunës;

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar rishikimin e buxhetit të komunës sipas propozimeve të dhëna nga ekzekutivi I komunës.

11.Vendim për miratimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis.

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar planin lokal për veprim në mjedis për periudhën 2012- 2016 për territorin e komunës së Fushë Kosovës.

12.Vendim për refuzimin e kërkesës së paraqitur nga NTP 'Besi Com' për eksplotimin dhe ndarjen e gurit gëlqeror në Ngastrën Kadastrale Nr. 1307-0, në ZK Bardh i Madh.

Me këtë vendim Kuvendi ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga NTP 'Besi Com' për eksplotimin dhe ndarjen e gurit gëlqeror në Ngastrën Kadastrale Nr. 1307-0, në ZK Bardh i Madh.

13.Vendim për shpalljen 'Qytetar Nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2012.

Me këtë vendim Kuvendi ka miratuar propozimin e kryetarit që Prof. Dr. Jusuf Osmani të nderohet duke i dhënë titullin Qytetar Nderi i komunës së Fushë Kosovës për vitin 2012 me motivacion për kontributin dhe përkushtimin e dhënë në fushën e arkivistikës në Kosovë dhe për botimin e shumë veprave e punimeve shkencore për lëndët arkivore.

14.Vendim për caktimin e ofertuesit nga konkurrimi i operatorëve ekonomik për marrjen në shfrytëzim me qira të objektit për Çerdhe të Fëmijëve në Fushë-Kosovë.

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar propozimin e ofertuesit nga konkurrimi i operatorëve ekonomik për marrjen në shfrytëzim me qira të objektit për Çerdhe të Fëmijëve në Fushë-Kosovë.

15.Vendim për shqyrtimin e lejimit të pagesës së kujdestarive për punëtorët shëndetësorë nga participimi në shërbimet shëndetësore.

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar propozimin për lejimit të pagesës së kujdestarive për punëtorët shëndetësorë nga participimi në shërbimet shëndetësore.

16.Vendim për caktimin e çmimit për shfrytëzuesit e banesave në fshatin, Miradi e Eperme.

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar propozimin për caktimin e çmimit për dhënien me qira të 58 banesave në kompleksin banesor Miradi të Eperme për kategoritë e cekura si vijon; kategoritë e familjeve në asistencë sociale, familjet e dëshmove dhe martirëve si dhe kategoritë tjera të banuesve, ky kompleks banesor do të shfrytëzohet nga Qendra për punë sociale.

Komuna e Shtimes

Kuvendi i Komunës së Shtimës gjatë periudhës janar – qershor 2012 ka miratuar 45 vendime dhe 1 rregullore.

Janar-Qershor 2012

Rregulloret

1.Rregullore komunale për ndarjen e bursave për student

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për aplikim, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia bursës, procedurat e përzgjedhjes së përfituesve të bursave, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesës.

Vendimet

1. Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2011,

Më këtë vendim kuvendi ka bërë bartjen e mjeteve nga viti 2011, gjithsej shuma e bartur është 46092.28 e ndare ne programet rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së, kompletimi i fushës së futbollit në shk. Fillore Emin Duraku si dhe pagesa e pagave në shëndetësi.

2. Vendim për refuzimin e kërkesës së Smajl Ramadanit-Vojnovc

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, refuzoj kete kerkes me arsyetimin se ende nuk eshte kompletuar lenda.

3. Vendim për refuzimin e kërkesës së Adem Tafes Shtime

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori vendim per refuzimin e kësaj kerkes me arsyetimin se nevojitet material shtesë per shqyrtimin e kësaj lende.

4. Vendim për refuzimin e kërkesës së Naser Bytyqit Prishtinë.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori vendim që të refuzohet, me arsyetimin se: 1. Nënqirambajtja për 99 vite nuk vërteton pronësinë e përhershme, 2. Nga ky ndërrim pronësie Komuna nuk ka ndonjë interes të veçantë, 3. Kërkesa është e pa kompletuar dhe me letra të pa vërtetuara.

5. Vendim për refuzimin e kërkesës së Muhamet roshaj Mollopollc;

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori vendim për refuzimin e kërkesës me arsyetimin se nuk ka buxhet.

6. Vendim për refuzimin e kërkesës së Naser Isenaj Petrove;

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori vendim të refuzohet me arsyetimin se: 1. Komuna nuk shet pasuri të paluajtshme (tokë) për arsye se nevojat e Komunës për sipërfaqe janë shumë të mëdha, 2. Komuna nuk i jep askujt pasuri të paluajtshme në shfrytëzim për qëllimin e përkujdesjes për pronën Komunale, 3. Çështja e rikultivimit të pyjeve është në kompetencë të Agjencionit të Ekonomisë Pyjore, 4. Kërkesa është e pa kompletuar dhe me letra të pa vërtetuara.

7. Vendim për refuzimin e kërkesës së Ismet Zeqirit OKPIP Shtime

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtoris për Administratë të Përgjithshme si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori vendim të refuzohet, me arsyetimin se: Kërkesa duhet t'i adresohet Ekzekutivit sepse Kuvendi Komunal ka aprovuar vendimin 01Nr. 06/1805 -234, datë: 15.9.2011, për ndarjen e Subvencioneve për vitin 2012

8. Vendim për refuzimin e kërkesës së Kujtim Osmani (RAE)

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete, si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori vendim të refuzohet me arsyetimin se: Kërkesa duhet t'i adresohet Ekzekutivit sepse Kuvendi Komunal ka aprovuar vendimin 01Nr. 06/1805 -234, datë: 15.9.2011, për ndarjen e Subvencioneve për vitin 2012.

9. Vendim për miratimin e raportit financiar;

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar raportin financiar të qeverisë komunale për vitin 2011.

10. Vendim për ndryshimin e vendimit të kuvendit 01 Nr. 06/177-10, për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2011;

Më këtë vendim kuvendi ka ndryshuar vendimin e kuvendit 01 Nr. 06/177-10, për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2011 sipas kërkesës së drejtorisë së ekonomisë dhe financa.

11. Vendim për përshtatjen buxhetore për tejkalimin e situatës aktuale të shkaktuara nga kushtet e vështirësuara atmosferike;

Më këtë vendim kuvendi ka bërë përshtatjen buxhetore për tejkalimin e situatës aktuale të shkaktuara nga kushtet e vështirësuara atmosferike sipas kërkesës së drejtorisë për ekonomi dhe financa.

12. Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2012,

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar planin e punës së Kuvendit për vitin 2012 në të cilin planë është paraparë orari i mbledhjeve si dhe agjenda që do të shqyrtohet gjatë kësaj periudhe.

13. Vendim që Rregullorja për ndarjen e bursave për student të kaloj në diskutim publik;

Më këtë vendim kuvendi ka kaluar në diskutim publik rregulloren për ndarjen e bursave për student.

14. Vendim për refuzimin e kërkesës së Bedri Kajtazi nga fshati Godanc i ulët, Kërkesa 01Nr.06/192 datë: 24.1.2012.

Më këtë vendim kuvendi ka refuzuar kërkesën më arsyetimin se tani presim miratimin e udhëzimeve administrative për implementimin e ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave.

15. Vendim për refuzimin e kërkesës së z. Egzonit Jakupit, përfaqësues i Klubit Futbollistik, KF-“Blindona” (Rr. “12 Qershor”) Shtime,

Më këtë vendim kuvendi ka refuzuar këtë kërkesë më arsyetimin se kjo kërkesë duhet ti drejtohet drejtorisë për kulturë rini dhe sport.

16. Vendim për refuzimin e kërkesës së Naim Arifaj ne emër te kompanisë Guri ka kërkuar qe te merr pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës private për nevojat e shfrytëzimit të kompanisë së tij;

Më këtë vendim kuvendi ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin që në mbledhjen e ardhshme ekzekutivi të plotësoj këtë kërkesë më material të detajuar dhe sa më të plotë.

17. Vendim për miratimin e raportit të punës të Komisionit për vlerësimin e Dëmeve të Luftës në Kosovë 1998-99, me qëllim të paraqitjes së padisë kundër shtetit të Serbisë, për dëmet e shkaktuara në Komunën e Shtimes

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar Raportin e punës të Komisionit për vlerësimin e Dëmeve të Luftës në Kosovë 1998-99, me qëllim të paraqitjes së padisë kundër shtetit të Serbisë, për dëmet e shkaktuara në Komunën e Shtimes. Sipas vlerësimit të Komisionit dëmet e përgjithshme materiale në Komunën e Shtimes të shkaktuara nga Serbia, janë vlerësuar në shumën e përgjithshme financiare prej: 45.831.300,50 euro, pa u llogaritur dëmet jo materiale, siç janë: (Dëmet dhe humbjet jo materiale si dhe vuajtjet shpirtërore të Vrarëve, të Plagosur, të Burgosur, të Torturuar, të Dhunuar, të Kidnapuar, të Depërtuar, të Zhdukur, të Maltretuar, të Traumatizuar, e të Frikësuar).

18.Vendim për dhënien e pëlqimit në kërkesën, 01.Nr.07/320 të Naim Arifit nga fshati Belincë;

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën 01Nr.07/320 të z.Naim Arifit nga fshati Belinc, përfaqësues i kompanisë ("GURI COMPANY-1") dhe i jep pëlqim për vendosjen e mekanizmit punues (Gurthyjes) në pronën e tij private në fshatin Belinc, te vendi i quajtur "Ara e jazit" në ngastrat kadastrale 656, 657, 658, me gjithësejt sipërfaqe 01.97.07, Nr. i Certifikatës: UL-72809006-00237, ZK-Belinc.

19.Vendim për ngritjen e çmimit të parkingut të automjeteve në parkingun publik në Shtime nga 0.20 centë në 0.30 cent.

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën 01Nr.07/346 të z.Safet Sylja përfaqësues i (OVL) dega në Shtime, dhe ka vendosur për ngritjen e çmimit nga, 0.20 cent sa ishte në: 0.30 cent për parkimin e automjeteve në parkingun publik, të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit Komunal-Shtime 01Nr.06/2063-251, datë 29.10.2010 për dhënien në menaxhim të përkohshëm, OVL-së, parkingjet dhe tregjet në Shtime.

20.Vendim për refuzimin e kërkesës 01.nr.07/360 të Enver Selmanit nga Shtime

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar që kërkesa me numër: 01Nr.07/360, datë 21.2.2012, e z.Enver Selmanit nga Shtimja të refuzohet, me arsyetimin se Komuna, ka Planin Zhvillimor, dhe kështu Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në momentin e caktimit të ndonjë zone për biznese të tilla, do të ndjek procedurat e shpalljes publike të ofertës për kërkesa të tilla.

21.Vendim për refuzimin e kërkesës 01.Nr.07/377 të Besim Ramadanit nga Shtime

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar që kërkesa me numër: 01Nr.07/377, datë: 24.2.2012, e z. Besim Ramadanit nga Shtimja të refuzohet, sipas rekomandimit të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, me arsyetimin që hapësirat publike varësisht nga buxheti janë kompetencë e institucioneve lokale dhe qendrore ta bëjnë pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura. Pala mund të aplikoi te Agjensioni Pyjor i Kosovës sepse është pronë e tyre dhe ata menaxhojnë me pronën vetë.

22.Vendim për riemërtimin e Çerdhes së fëmijëve në Shtime me Emrin "Albiona Asllani"

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar vendimin për riemërtimin e Çerdhes së Fëmijëve në Shtime në rrugën "Skenderbeu" me emrin "Albiona Asllani" fëmija më i vogël i familjes Asllani nga fshati Rancë të rënë martirë gjatë Luftës në Kosovë më 26 gusht 1998.

23.Vendim për dhënien e pëlqimit në kërkesën 01Nr. 07/494 të Imer Beqajt;

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën 01Nr.07/494 të z.Imer Beqaj nga Shtimja, përfaqësues i kompanisë ("FASADA") dhe i jep pëlqim për 50 (pesëdhjetë) ari sipërfaqe për vendosjen e mekanizmit punues (Gurthyes) në pronën private të z.Shyqeri Bajraktarit nga fshati Budakovë, KK-Suharekë, në vendin e quajtur "Ara te Mullini" pjesë nga ngastra kadastrale 150-0 me sipërfaqe prej 35 (tridhjetepesë) ari, si dhe pjesë nga ngastra kadastrale 183-0 me sipërfaqe prej 15 (pesëmbëdhjetë) ari; Numri i Certifikatës UL-72809084-00132, Z.K.- Topillë-Devetak.

24.Vendim për refuzimin e kërkesës 01. Nr.07/518;

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesa me numër: 01Nr.07/518, datë: 16.3.2012, e z.Agron Uka nga fshati Rancë të refuzohet, sipas rekomandimit të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, me arsyetimin që Komuna nuk ka ndonjë Vendim të veçantë për kategorinë e Veteranëve të Luftës, që të ju ndahen troje, kur dihet që numri i tyre është shumë i madh, me përjashtimin të Vendimit të Kuvendit Komunal - Shtime për ndarjen e trojeve për kategoritë e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe martirëve të Reqakut. Kërkesa të ngjashme ka pasur edhe më parë dhe janë refuzuar.

25.Vendim për dhënien e pëlqimit në kërkesën, 01Nr.07/536

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën 01Nr.07/536, të z.Mahmut Salihit nga fshati Godanc i poshtëm, përfaqësues i firmës SH.P.K "EDISI COM" dhe i jep pëlqim për eksplotimin e Gurit natyror në pronën e tij personale e cila gjindet në fshatin Belinc, në parcelat kadastrale nr. 542-0; 543-0; 544-0; 545-0; 546-0; 547-0; 548-0; 552-0; 553-0; 554-0; 610-0; 611-0. Gjithësejt sipërfaqe: 39403 m²,Numri i Certifikatës; UL-72809006-00257, Z.K.- Belinc,

26.Vendim për themelimin e komisionit për ndarjen e bursave për student;

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar Vendimin për themelimin e Komisionit për Ndarjen e Bursave për Studentë, prej 5 (pesë) anëtarëve, për vitin akademik 2011/12. Nga Kuvendi Komunal 2 (dy) anëtarë, me vota unanime u zgjodhën: 1. znj.Fatime Krasniqi, dhe znj. Agime Hasani, Nga Ekzekutivi 2 (dy) anëtarë të cilët i emëron Kryetari i Komunës sipas Detyrës zyrtare.

27.Vendim për aprovimin e raportit financiar janar –mars 2012;

28.Vendim për shpalljen e pronës me interes të përgjithshëm;

29.Vendim për shprehjen e interesit të komunës për shpalljen e ngastrave kadastrale nr.1843 dhe 1845 me interes të përgjithshëm;

30.Vendim për futjen ne listen prioritare të Sokol Bungut për ndërtimin e objektit të banimit;

31.Vendim për ne listën prioritare të hamide Xhemshitit për ndërtimin e objektit të banimit;

32.Vendim për futjen ne listen prioritare të Ismet Halilit për ndërtimin e objektit të banimit;

33.Vendim për futjen ne listën prioritare të Ruzhdi Veliut per ndertimin e objektit të banimit;

34.Vendim për dhënien e pëlqimit në kërkesën 01.Nr.07/709 të Mehmet Ismailit nga Fshati Prelez I Jerlive K, K Ferizaj

35.Vendim për refuzimin e kërkesës 01.Nr0776 të Muhamed Himay nga Prishtina;

36. Vendim për rikonfirmimin e vendimit 01.Nr.06/552-6;

37.Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2012

Më këtë vendim kuvendi ka miratuar raportin financiar të qeverisë komunale për vitin 2011.

38.Vendim për miratimin e KASH-it që të kaloj në diskutim publik

Më këtë vendim kuvendi ka kaluar në diskutim publik për një muaj Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013-2015.

39.Vendim për anulimin e kuvendit 01Nr.06/570-66 datë 30.03.2012 për dhënien e pëlqimit në kërkesën 01 Nr.07/494 të Imer Beqaj nga Shitma;

Më këtë vendim kuvendi ka anuluar vendimin e marrë më datën 30.03.2012, dhe ka anuluar pëlqimin e dhenë në kërkesën e Imer Beqajt nga Shitma.

40.Vendim për Plotësimin e Vendimit për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2012.

Me këtë vendim kuvendi ka miratuar plotësim ndryshimin e vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

41.Vendim për plotësimin e vendimit 01Nr.06/981-113 për rishikimin e Buxhetit të vitit 2012

Me këtë vendim është aprovuar plotësim ndryshimi i vendimit 01Nr.06/981-113 për rishikimin e Buxhetit të vitit 2012

42.Vendim për aprovimin e Kornizës Afatmesme të Buxhetore Komunale 2013-2015

Me këtë vendim është aprovuar Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale, 2013-2015 sipas Rekomandimit të Komitetit për Politik dhe Financa, pas diskutimit publik me qytetarët e Komunës, sipas vendimit të Kuvendit Komunal-Shtime 01Nr.06/981-114, datë: 28.5.2012, në mbështetje të nenit 61.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, si dhe nenit 8 të Rregullores Komunale për Transparencën 01Nr.06/361/4, datë.4.3.2009.

43.Vendim për dhënien e Pëlqimit për vendosjen e Gurthyesit Muhamet Himay-Prishtinë

Me këtë vendim kuvendi ka aprovuar kërkesën 01Nr.07/968 të z.Muhamed Himay nga Prishtina, përfaqësues i firmës ("Dragon Çelik") dhe i jep pëlqim për shfrytëzimin e gjithësejt 55 (pesëdhjetepesë) ari sipërfaqe, prej tyre 34 (tridhjetekatër) ari sipërfaqe pjesë nga ngastra kadastrale 150-0, vendi i quajtur "Zabeli përmbi shtëpi", si dhe 21 (njëzetnjë) ari sipërfaqe pjesë nga ngastra kadastrale 183-0, vendi i quajtur "Ara te mullini". Numri i Certifikatës UL-72809084-00132, Zona Kadastrale Topillë-Devetak. Evidentuar pronë private e z.Shyqeri Bajraktarit me vendbanim në fshatin Luzhak, me të cilin shfrytëzuesi z.Muhamed Himay, ka kontratë 10 vjeçare të vërtetuar në Gjykatë për shfrytëzimin e sipërfaqes. Pëlqimi palës i është lëshuar për vendosjen e mekanizmit punues (Gurthyes), në këtë sipërfaqe, me qëllim të përpunimit të Gurit natyror.

44.Vendim për Refuzimin e Kërkesës 01Nr.07/1007 të Hajri Xhelilit nga Shtimja

Me këtë vendim kuvendi vendosi që kërkesa 01Nr.07/1107, e Hajri Xhelilit nga Shtimja, të Refuzohet me arsyetimin se fillimisht duhet që të shpenzohen resurset nga sipërfaqja për të cilën Kuvendi ka dhënë pëlqim me numër 01Nr.06/8255-4 të datës: 24.9.2007, e pastaj mund të paraqitet kërkesë për zgjerimin e sipërfaqes.

45.Vendim për aprovimin e Rekomandimeve 01Nr. 06/1116-140 të KSHP-së

Me këtë vendim kuvendi ka vendosur që të aprovoi Rekomandimet, 01Nr.06/1116-140, të datës: 19.6.2012, të Komitetit për Shërbime Publike si vijon:

1. Të ngritet niveli i bashkëpunimit të Komunës me Kompanitë Publike,
2. Të shtohet kontrolli nga Kompanitë Publike, në bashkëpunim edhe me Inspektoratin Komunal ndaj keqpërdoruesve të ujit, dhe mbeturinave.
3. Të evidentohen kyqjet ilegale dhe të punohet për eliminimin e tyre.
4. Të shikohet mundësia teknike e aktivizimit të pusit Nr.2, të ujit në Rashincë, ose hapja e një pusi të ri.

Komuna e Gjilanit

Kuvendi i Komunës së Gjilanit gjatë periudhës janar - qershor 2012 ka miratuar 44 vendime dhe 3 rregullore.

Janar-Qershor

Rregulloret

1.Rregullore për ndarjen e subvencioneve;

Me këtë Rregullore, përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të Komunës- fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale, personave fizik dhe juridik

2.Rregullore mbi procedurat dhe kriteret për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve, lapidareve dhe simboleve;

Me këtë Rregullore, përcaktohet procedura dhe kriteret për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve në hapësira publike, brenda territorit të Komunës së Gjilanit.

3.Rregullore për Shërbimet Publike Komunale

Me këtë Rregullore, përcaktohen të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, institucioneve dhe të ndërmarrjeve në lëmin e shërbimeve publike në territorin e Komunës së Gjilanit.

Vendimet

1.Vendim për rishikimin e përbërjes së Komiteteve të KK-së Gjilan

Me këtë vendim, bëhet rishikimi i Vendimit 01.Nr.3642 i datës 26.03.2010. për caktimin e përbërjes së Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

2.Vendim për miratimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2012

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Planin e punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2012.

3.Vendim për aprovimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-së Gjilan për vitin kalendarik 2012

